

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Profilin Mësimor

FERMA BUJQESORE
DHE BLEGTORALE

Niveli II

(Në drejtimin mësimor BUJQËSI)

Kodi: H2-II-18

Miratoi:

MINISTRI

Tiranë, 2018

Përmbajtja:

- I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli II, të drejtimit mësimor “Bujqësi”.**
- II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli II.**
 1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli II
 2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli II
 3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli II
 4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në në profilin “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli II.
- III. Plani mësimor për profilin “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli II.**
- IV. Udhëzime për planin mësimor**
- V. Udhëzime për procesin mësimor.**
- VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**
- VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në profilin “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli II,**
- VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**
- IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**
- X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.**

I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli II, të drejtimit “Bujqësi”.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Ferma bujqësore dhe blegtorale, niveli II, të drejtimit “Bujqësi”, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me fermat bujqësore dhe blegtorale. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:*

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profili “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli II

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli II

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor “Ferma bujqësore dhe blegtorale” niveli II, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “Bujqësi”, niveli I;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MFE përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim të arsimit në profilin “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli II

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli II, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.

- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin mësimor “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli II.

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli II, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në nivelin I, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të konceptojë planin për hapjen e një biznesi të vogël në veprimtaritë profesionale përkatëse.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me veprimtaritë profesionale përkatëse.
- Të bëjë organizimin e vogël të punës në punimet e fermës bujqësore e blegtorale.
- Të interpretojë, plotësojë dhe përgatisë dokumentacionin teknik të profesionit.
- Të prodhojë fidanë të kulturave frutore.
- Të përdorë preparate kimike të kulturave bujqësore në fermë.
- Të ndërtojë rrjetin kullues të fermës.
- Të përpunojë produktet bujqësore e blegtorale të fermës.
- Të trajtojë kafshët e qumështit.
- Të kujdeset për kafshët gjatë periudhës së riprodhimit të tyre.
- Të përdorë dhe mirëmbajë veglat, pajisjet dhe materialet e punës.
- Të zbatojë standardet e profesionit gjatë punimeve dhe shërbimeve në ferma.
- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë e të mbrojtjes së mjedisit.

III. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtëjshëm në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli II.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli II, e pajis nxënësin me certifikatën e punonjësit të kualifikuar në këtë profil profesional. Ky arsimim i jep mundësi nxënësit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar në ferma bujqësore e blegtorale ose për t’u vetëpunësuar në to. Mbas një përvoje pune dhe trajnimeve të mëtëjshme, ai mund të krijojë një biznes të vogël në punimet dhe shërbimet që kryhen në fermë dhe të punësojë të tjerë në të.

Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin III

(teknik/manaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin/profilin përkatës, për të fituar diplomën e “Maturës shtetërore profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare dhe pas të mesmes.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin mësimor “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli II

Plani mësimor për profilin mësimor “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli II			
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/vjetore
			Klasa 12
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	8/9 (272/306)
1		Gjuhë shqipe	1
2		Letërsi	1
3		Gjuhë e huaj e parë	2
4		Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(1)
5		Matematikë	2
6		TIK	1
7		Edukim fizik, sporte, shëndet	1
B.		Lëndët profesionale (Gjithsej)	7 (238)
1	L-17-157-10	Bazat e sipërmarrjes	2
2	L-14-188-10	Toka dhe përdorimi i saj	1
3	L-14-189-10	Mbrojtje bimësh	1
4	L-14-190-10	Të ushqyerit e kafshëve bujqësore	2
5	L-08-191-10	Përpunimi i produkteve bujqësore e blegtorale	1
C.		Module të detyruar të praktikës profesionale (Gjithsej)	12 (408)
1	M-14-514-10	Prodhimi i kulturave drufrutore	84
2	M-14-515-10	Përdorimi i preparateve kimike te kulturat e fermës	51
3	M-14-516-10	Ngritja e rrjetit kullues në fermë	51
4	M-14-517-10	Sistemimi i tokës bujqësore	51
5	M-08-518-10	Përpunimi i produkteve bujqësore e blegtorale të fermës	84
6	M-14-519-10	Trajtimi i kafshëve të qumështit	51
7	M-14-520-10	Kujdesi gjatë riprodhimit të kafshëve bujqësore	36
D.		Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar (Gjithsej)	3 (102)
1	M-14-521-10	Sistemimi estetik i kopshteve	51
2	M-14-522-10	Shtimi dhe shërbimet te hardhia	51
3	M-19-240-09	Përgatitja me krah e barit të thatë	51
4	M-14-523-10	Ujitja e bimëve të arave e perimeve	51
		Gjithsej A+B+C+D	30/31 (1020/ 1054)

IV. Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 2 javë provime)

Një javë mësimore ka jo më shumë se 32 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në profilin “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli II, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për profilet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASR).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithëshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që *planifikimi i mësimdhënies* të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritetit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “*të nxënësit duke bërë*” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të profilit mësimor “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli II.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathhtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimin (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënësit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të profilit profesional “Ferma bujqësore dhe blegtorale”.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 12-të, nxënësi i arsimuar në profilin mësimor “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli II, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;
- b) Provimi i praktikës profesionale të integruar;

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e ndërtimit, dhe u jepet certifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme, si dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit II.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli II

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në profilin mësimor “Ferma bujqësore dhe blegtorale”, niveli II, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Dëftesën e përfundimit të këtij niveli si dhe me Certifikatën e aftësisë profesionale, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:
 - rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale,
 - rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit II.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-157-10). Kl. 12 – 68 orë

- **Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë sipërmarrjen me të gjithë elementët kryesorë të saj
- Të shpjegojnë lidhjen midis sipërmarrjes dhe veprimtarisë njerëzore
- Të shpjegojnë ndikimin e sipërmarrjes në biznes
- Të shpjegojnë funksionet themelore të organizimit të punës në biznes
- Të përshkruajnë veçoritë e tregut dhe veprimtaritë që kryhen në të
- Të përshkruajnë llojet e konsumatorëve, kërkesat specifike për mallra/sherbime dhe reagimet e tyre ndaj sinjaleve të marketingut të një sipërmarrjeje
- Të shpjegojnë kuptimin e institucioneve financiare dhe rolin e tyre në biznes
- Të shpjegojnë kuptimin e bankave dhe shërbimet e tyre
- Të shpjegojnë kuptimin, rëndësinë, mjetet dhe strategjitë e marketingut
- Të listojnë katër *P*-të e marketingut
- Të përshkruajnë konceptet bazë të legjislacionit dhe etikës së biznesit.
- Të shpjegojnë rëndësinë e legjislacionit të punës dhe elementet përbërës të tij.
- Të kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike të një aktiviteti sipërmarrës
- Të shpjegojnë rëndësinë, nevojën dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12 - 68 orë**

Tema 1	Njohuri të përgjithshme mbi sipërmarrjen	3 orë
Tema 2	Sipërmarrja dhe aktiviteti njerëzor	4 orë
Tema 3	Sipërmarrja dhe biznesi	8 orë
Tema 4	Organizimi i punës në biznes	9 orë
Tema 5	Tregu dhe sjellja konsumatore	6 orë
Tema 6	Institucionet financiare	7 orë
Tema 7	Njohuri për Marketingun	5 orë
Tema 8	Legjislacioni dhe etika e biznesit	5 orë
Tema 9	Legjislacioni i punës	7 orë
Tema 10	Llogaritje të thjeshta ekonomike	10 orë
Tema 11	Aspekte të TIK-ut në biznes	4 orë

2. Lënda “Toka dhe përdorimi i saj”, (L-14-188-10). Kl. 12 – 34 orë

- **Synimet e lëndës “Toka dhe përdorimi i saj”, kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Toka dhe përdorimi i saj”, kl.12, nxënësit duhet:

- Të përkufizojnë tokën bujqësore.
- Të argumentojnë ndikimin e alterimit fizik, kimik dhe biologjik të shkëmbinjve të tokës.
- Të përshkruajnë ndikimin e faktorëve pa jetë, me jetë dhe të njeriut në formimin e tokës bujqësore .
- Të analizojnë profilin e tokës dhe përbërjen mekanike të saj.

- Të krahasojnë cilësitë e tokave me përbërje të ndryshme mekanike.
- Të përshkruajnë lëndën organike në tokë, burimet dhe përbërësit e humusit në tokë.
- Të përcaktojnë masat agroteknike për përmirësimin e strukturës së tokës.
- Të përshkruajnë koloidet e tokës, aftësinë thithëse të koloideve dhe llojet e thithjes.
- Të përcaktojnë tokat me reaksione (ph) të ndryshme dhe për përmirësimin e ph së tokës.
- Të përshkruajnë aftësinë buferike të tokave.
- Të interpretojë veçoritë e përgjithshme të tokës, si dhe veçoritë fiziko-mekanike të saj.
- Të klasifikojnë tokat sipas kriterit empirik, agrogjeologjik dhe gjenetiko-agronomik.
- Të dallojnë tipet e ndryshme të tokave.
- Të përshkruajnë hapat teknologjikë të plugimit të tokës.
- Të përshkruajnë hapat teknologjikë të punimeve sipërfaqësore (diskim, frezim, lesim, rulim dhe kultivim) të tokës.
- Të përshkruajnë hapat teknologjike të punimit të tokës sipas relievit dhe tipit të tokës.
- Të përshkruajnë hapat teknologjike të punimit të tokës sipas kulturave të vjeshtës dhe të pranverës.
- Të argumentojnë rolin e makro dhe mikroelementeve në jetën e bimës.
- Të shpjegojnë marrjen e lëndëve nga rrënjët e bimëve.
- Të krahasojnë llojet e plehrave kimike (azotike, fosforike dhe potasike) dhe ndikimin e tyre në pjellorinë e tokës.
- Të shpjegojnë përdorimin e plehrave komplekse dhe përparësitë e plehërimit të lëngshëm.
- Të dallojnë llojet e plehrave organike dhe ndikimin e tyre në përmirësimin e cilësive fiziko-kimike të tokës.
- Të përshkruajnë plehërimin e gjelbër sipas llojit të bimësisë që përdoret.
- Të përshkruajnë plehërat bakteriale.
- Të përshkruajnë mënyrat e ujitjes (sipërfaqësore, shihedhje dhe me pika) dhe hapat teknologjikë të realizimit të tyre.
- Të përshkruajë anët pozitive të fertigimit (ujitje +plehërim)
- Të përshkruajnë skemat e rrjetit të kanaleve kulluese (K₁K, K₂K, K₃K).
- Të përshkruajnë llojet e drenave dhe vendosjen e tyre.
- Të përshkruajnë hapat teknologjikë të sistemimit sipërfaqësor të tokave në formën kurriz dhe rrafsh.
- Të përshkruajnë hapat teknologjikë të sistemimit të tokave të pjerrëta me mënyra të ndryshme.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Toka dhe përdorimi i saj”, kl 12 - 34 orë**

Tema 1	Njohuri për tokën bujqësore	2 orë
Tema 2	Njohuri për morfologjinë e tokave	3 orë
Tema 3	Koloidet e tokës	1 orë
Tema 4	Reaksioni i tokave dhe teknologjia e përmirësimit të tij	2 orë
Tema 5	Veçoritë fizike kryesore të tokave	2 orë
Tema 6	Klasifikimi i tokave	3 orë
Tema 7	Teknologjia e punimit të tokës	4 orë
Tema 8	Teknologjia e plehërimit të tokës	4 orë

Tema 9	Teknologjia e ujitjes së tokës	4 orë
Tema 10	Teknologjia e kullimit të tokës	5 orë
Tema 11	Teknologjia e sistemimit të tokës	4 orë

3. Lënda “Mbrojtje bimësh” (L-14-189-10). Kl. 12 – 34 orë

- **Synimet e lëndës “Mbrojtje bimësh”, kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Mbrojtje bimësh”, kl.12, nxënësit duhet:

- të përshkruajnë rolin, qëllimin dhe rëndësinë e mbrojtjes të bimëve në vendin tonë.
- Të tregojnë vlerësimin ekonomik të dëmeve të shkaktuara nga sëmundjet dhe dëmtuesit e bimëve.
- të përkufizojnë ç’janë sëmundjet e bimëve bujqësore dhe si klasifikohen ato.
- Të përcaktojnë faktorët abiotik (pa jetë) dhe biotik (me jetë) si shkaktarë të sëmundjeve të ndryshme.
- Të përshkruajnë se ç’janë viruset, përbërjen e tyre dhe tiparet e sëmundjeve virusale.
- Të përshkruajnë ndërtimin, biologjinë dhe klasifikimin e bakterieve fitopatogjene si dhe shenjat e sëmundjeve bakteriale.
- Të shpjegojnë mënyrat e shumimit, ciklit jetësor të kërpudhave, klasifikimin dhe veçantitë e çdo klase.
- Të shpjegojnë sëmundjen si proces patologjik, fazat, mënyrat e përhapjes së sëmundjeve, diagnostikimin dhe qëndrueshmërinë (imunitetin) e bimëve ndaj sëmundjeve.
- Të përshkruajnë ndërtimin, biologjinë dhe dëmet që shkaktajnë nematodat, kërmintë, këpushat, si dhe masat e luftimit ndaj tyre.
- Të tregojnë ndërtimin e insekteve (kandrrave), ndryshimet e aparateve gojore, ciklin e zhvillimit, mënyrat e riprodhimit dhe metamorfozat.
- Të tregojë klasifikimin e insekteve, dallimet midis rendeve dhe dëmet vlerësuese të shkaktuara nga dëmtuesit e kulturave bujqësore.
- Të identifikojnë rolin e faktorëve ekologjikë në zhvillimin dhe shumimin e parazitëve dhe dëmtuesve.
- Të analizojnë metodat e vrojtimit, të prognozimit e të sinjalizimit të sëmundjeve dhe të dëmtuesve.
- Të përshkruajnë metodat e ndryshme të luftimit të sëmundjeve dhe dëmtuesve të kulturave bujqësore.
- Të përshkruajnë preparatet kryesore kryesore aktuale që përdoren për luftimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve.
- Të theksojnë rregullat e përdorimit të ruajtjes së preparateve kimike, si dhe të dhënies së ndihmës së parë në rast rreziku.
- Të tregojë si është i organizuar shërbimi i mbrojtjes së bimëve në komunë dhe legjislacionin ekzistues.
- Të tregojë përhapjen, përshkrimin, shenjat e dëmtimit dhe masat e luftimit ndaj dëmtuesve e sëmundjeve polifage në kulturat bujqësore.
- Të përshkruajnë karakteristikat kryesore të sëmundjeve dhe dëmtuesve të drithërave, si dhe masat e luftimit ndaj tyre
- Të dallojnë të përbashkëtat dhe të veçantat e sëmundjeve dhe të dëmtuesve të patates, perimeve e bimëve bishtajore në bashkëlidhje me përdorimin efikas të masave të luftimit
- Të përshkruajnë specifikat e sëmundjeve dhe dëmtuesve kryesorë të bimëve industriale, si dhe masat e luftimit ndaj tyre sipas kushteve të zonës apo rajonit

- Të identifikojnë tiparet, përhapjen, mënyrat e jetesës, dëmet dhe masat e luftimit të sëmundjeve dhe dëmtuesve kryesorë të pemëve frutore, ullirit, agrumeve dhe hardhisë.
- Të përshkruajnë disa nga dëmtuesit e prodhimeve të ruajtura në depo dhe masat efikase të luftës ndaj tyre.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mbrojtje bimësh”, kl 12 - 34 orë**

Tema 1	Mbrojtja e bimëve si shkencë, rëndësia e saj.	2 orë
Tema 2	Bima e kultivuar si objekt i mbrojtjes së bimëve	3 orë
Tema 3	Dëmtuesit e kulturave bujqësore	4 orë
Tema 4	Faktorët ekologjik dhe metodat e luftimit të sëmundjeve e dëmtuesve, preparatet kryesore	5 orë
Tema 5	Shërbimi i mbrojtjes së bimëve në vendin tonë dhe legjislacioni për përdorimin dhe ruajtjen e preparative	1 orë
Tema 6	Dëmtuesit dhe sëmundjet polifage	3 orë
Tema 7	Sëmundjet dhe dëmtuesit e drithërave	3 orë
Tema 8	Sëmundjet dhe dëmtuesit e patates, perimeve dhe bimëve bishtajore	5 orë
Tema 9	Sëmundjet dhe dëmtuesit e bimëve industriale	3 orë
Tema 10	Sëmundjet dhe dëmtuesit e pemëve frutore, ullirit, agrumeve dhe hardhisë	4 orë
Tema 11	Dëmtuesit e prodhimeve në depo	1 orë

4. Lënda “Të ushqyerit e kafshëve bujqësore” (L-14-190-10). Kl. 12 – 68 orë

• **Synimet e lëndës “Të ushqyerit e kafshëve bujqësore”, kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Të ushqyerit e kafshëve bujqësore”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë rëndësinë ekonomike të derrit, gjedhit, dhenve, shpendëve.
- Të shpjegojnë përbërjen kimike të ushqimeve dhe koeficientin e tretshmërisë.
- Të përshkruajnë teknologjinë e përgatitjes së silazhit dhe senazhit.
- Të përshkruajnë teknologjinë e përgatitjes së ushqimeve të koncentruara.
- Të shpjegojnë përgatitjen e qumështit nga soja e tërshëra.
- Të përshkruajnë etapat e përpilimit dhe strukturën e një racioni ushqimor.
- Të shpjegojnë normat ushqimore që nevojiten për mirëmbajtje, prodhim dhe riprodhim në kafshë dhe shpendëve.
- Të shpjegojnë teknikat e përpilimit të një racioni ushqimor për kafshët dhe shpendët.
- Të përshkruajnë të ushqyerit e deleve barse dhe qengjave
- Të hartojnë racione ushqimore për gjedhin, të imtat, derrat dhe shpendët.
- Të hartojnë nevojat për energji, proteina, lëndë minerale dhe vitamina në kafshët për mish si: gjedh, derra, dhen, etj
- Të shpjegojnë teknologjinë e të ushqyerit të gjedhit sipas fazave fiziologjike.
- Të përshkruajnë të ushqyerit e lopëve barse, në tharje dhe në laktacion.
- Të përshkruajnë të ushqyerit e viçave, gicave dhe qengjave sipas grupmoshave.
- Të shpjegojnë përlllogaritjen e lopëve foragjere, të prodhimit të qumështit dhe përqindjes së yndyrës.
- Të përshkruajnë teknologjinë e rritjes, regjimin, kujdesin dhe pajisjet te shpendët.
- Të përshkruajnë nevojat për lëndë minerale dhe vitamina në shpendët për mish dhe vezë.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës "Të ushqyerit e kafshëve bujqësore" kl. 12 - 68 orë**

Tema 1	Përbërja e ushqimeve.	3 orë
Tema 2	Teknologjia e përpunimit të ushqimeve.	9 orë
Tema 3	Normat e ushqimeve në kafshë.	5 orë
Tema 4	Teknika e hartimit të racioneve ushqimore në kafshë e shpendë.	10 orë
Tema 5	Nevojat e kafshëve për energji dhe mikroelementë.	10 orë
Tema 6	Të ushqyerit e të imtave.	8 orë
Tema 7	Të ushqyerit e derrave.	6 orë
Tema 8	Të ushqyerit e gjedhit.	10 orë
Tema 9	Të ushqyerit e shpendëve.	7 orë

5. Lënda "Përpunimi i produkteve bujqësore e blegtorale" (L-08-191-10). Kl.12 – 34 orë

- **Synimet e lëndës "Përpunimi i produkteve bujqësore e blegtorale", kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës "Përpunimi i produkteve bujqësore e blegtorale", kl.12, nxënësit duhet:

- Të theksojnë rëndësinë ekonomike të përpunimit e ruajtjes së produkteve bujqësore e blegtorale.
- Të përshkruajnë cilësitë, klasifikimin, mjete dhe teknologjinë e përpunimit e të ruajtjes së produkteve të drithërave.
- Të përshkruajnë lëndën e parë, përbërjen kimike dhe kultivarët e rrushit që rriten në vendin tonë.
- Të përshkruajnë pajisjet dhe makineritë e përpunimit të rrushit.
- Të përshkruajnë teknologjinë e përpunimit të rrushit për verë të kuqe e të bardhë etj.
- Të tregojnë mënyrat e ambalazhimit e të ruajtjes së prodhimeve të përpunuara të rrushit.
- Të përshkruajnë cilësitë, përbërjen kimike të frutave që përdoren si lëndë e parë në industrinë e përpunimit.
- Të përshkruajnë rëndësinë, mjetet dhe teknologjinë e përpunimit të frutave për komposto, lëng, reçel etj.
- Të tregojnë mënyrat e ambalazhimit e të ruajtjes së prodhimeve të përpunuara të frutave.
- Të përshkruajnë cilësitë, përbërjen kimike të perimeve që përdoren si lëndë e parë në industrinë e përpunimit.
- Të përshkruajnë rëndësinë, mjetet dhe teknologjinë e përpunimit të perimeve për salcë, turshi etj.
- Të tregojnë mënyrat e ambalazhimit e të ruajtjes së prodhimeve të përpunuara të perimeve.
- Të përshkruajnë cilësitë, përbërjen kimike të bimëve vajore që përdoren si lëndë e parë në industrinë e përpunimit.
- Të përshkruajnë rëndësinë, mjetet dhe teknologjinë e përpunimit të bimëve vajore.
- Të tregojnë mënyrat e ambalazhimit e të ruajtjes së prodhimeve të përpunuara të bimëve vajore.
- Të përshkruajnë cilësitë, përbërjen kimike të qumështit që përdoret si lëndë e parë në industrinë e përpunimit.
- Të përshkruajnë rëndësinë, mjetet dhe teknologjinë e përpunimit të qumështit për konsum të freskët, kos, djathë, gjizë etj.

- Të tregojnë mënyrat e ambalazhimit e të ruajtjes së prodhimeve të përpunuara të qumështit.
 - Të përshkruajnë rëndësinë, cilësitë, përbërjen kimike të mishit që përdoret si lëndë e parë në industrinë e përpunimit.
 - Të përshkruajnë rëndësinë e kontrollit të kafshëve dhe të shpezëve para therjes së tyre.
 - Të tregojë mjetet dhe pajisjet dhe mënyrat e therjes së kafshëve e shpezëve.
 - Të tregojnë mënyrat e ambalazhimit e të ruajtjes së prodhimeve të përpunuara të mishit.
- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Përpunimi i produkteve bujqësore e blegtorale”, kl 12 - 34 orë**

Tema 1	Rëndësia e përpunimit dhe e ruajtjes të produkteve bujqësore e blegtorale.	2 orë
Tema 2	Përpunimi dhe ruajtja e drithrave	4 orë
Tema 3	Përpunimi dhe ruajtja e rushit	4 orë
Tema 4	Përpunimi dhe ruajtja e frutave	5 orë
Tema 5	Përpunimi dhe ruajtja e perimeve	5 orë
Tema 6	Përpunimi dhe ruajtja e bimëve vajore	4 orë
Tema 7	Përpunimi dhe ruajtja e qumështit	5 orë
Tema 8	Përpunimi dhe ruajtja e mishit	5 orë

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

1. Moduli “Prodhimi i kulturave drufrutore”

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Ferma bujqësore dhe blegtorale
Niveli: II
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PRODHIMI I KULTURAVE DRUFRUTORE	M-14-514-10
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për zbatimin e teknikave për piketimin, shartimin, shërbimet agroteknike, si dhe llogaritjen e shpenzimeve në prodhimin e kulturave drufrutore.	
Kohëzgjatja e modulit	84 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të kualifikimit në drejtimin mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi piketon ngastrën për ngritjen e minipemëtores.</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">– Përzgjedhja e mjeteve e materialeve për hartimin e një skeme piketimi.– Përzgjedhja e veglave e mjeteve për piketimin e minipemëtores.– Hartimi i skemës së piketimit në formë katrore.– Piketimi në formë katrore.– Hartimi i skemës së piketimit në formë trekëndëshe.– Piketimi në formë trekëndëshi.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së piketimit të ngastrës për ngritjen e një minipemëtoresje. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përzgjedhë mjetet e materialet për hartimin e një skeme piketimi.– të përzgjedhë veglat e mjetet për piketimin e minipemëtores.– të hartojë një skemë të piketimit në formë katrore.– të piketojë në formë katrore ngastrën, sipas skemës.– të hartojë një skemë të piketimit në formë trekëndëshe.– të piketojë në formë trekëndëshe ngastrën, sipas skemës.– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së	

mjedisit gjatë kryerjes së piketimit të ngastrës për ngritjen e një minipemëtoreje.

RM 2 Nxënësi kryen shartime me syth dhe kalem në kulturat drufrutore.

Përmbajtja:

- Sigurimi i veglave dhe i materialeve të shartimit.
- Përcaktimi i momentit të shartimit.
- Sigurimi i mbishartesave dhe ruajtja e tyre.
- Kryerja e shartimit me syth:
 - Prerja në formë “T” e nënshartesës dhe hapja e lëvres.
 - Nxjerrja e sythit nga kalemata e mbishartesës.
 - Vendosja e sythin në pjesën e “T-së”.
 - Lidhja me rrafje e pjesës së shartuar.
- Kryerja e shartimit me kalem:
 - Prerja rrafsh ose me pak pjerrësi e nënshartesës.
 - Çarja vertikale e lëvres së nënshartesës me gjatësi 3-4 cm.
 - Shqitja e lëvres së çarë nga druri.
 - Përgatitja në formë gjuhëze e mbishartesës me dy sytha (kalem)
 - Vendosja e kalemmit tek nëshartesa dhe puthitja e tyre.
 - Lidhja e kalemmit të shartuar nga poshtë – lart.
 - Izolimi i vendit të shartimit me mastiç.
- Kontrolli i zënies së shartesave.
- Rishartimi në rastet e pazëna.
- Kryerja e shërbimeve pas shartimit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë shartimeve me syth e kalem.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të sigurojë veglat dhe materialet e nevojshme për kryerjen e shartimit me syth të fjetur dhe me kalem nën lëvore.
- të përcaktojë momentin e shartimit duke u nisur nga trashësia rreth 10 mm dhe lartësia 15- 20 cm nga toka tek filizi ose në degë.
- të sigurojë dhe ruajë mbishartesa, sipas kushteve të përcaktuara.
- të marrë kalemata e pjekur të mbishartesat për nxjerrjen e sythave.
- të kryejë shartimin me syth sipas procedurës së mëposhtme:
 - të kryejë prerje në formë “T-je” .
 - të hapë lëvoren.
 - të nxjerrë sythin nga kalemata e mbishartesës, sipas procedurës përkatëse.
 - të vendosë sythin në pjesën e “T-së”, rrafsh në pjesën e sipërm
 - të lidhë me rrafje, pjesën e shartuar, nga poshtë lart duke lënë zbuluar sythin.
- të kryejë shartimin me kalem sipas procedurës së mëposhtme
 - të përcaktojë pemët që do të shartohen (ulli, hurmë, man, arrë)
 - të presë rrafsh ose me pak pjerrësi nënshartesën.

- të çajë vertikalisht lëvoren e nënshartesës në gjatësi 3-4 cm dhe shqitë lëvoren nga druri.
- të përgatisë në formë gjuhëze mbishartesën me dy sytha (gjuhë formohet nën sythin e poshtëm).
- të vendosë mbishartesën tek nënshartesa dhe të puthitë mirë gjuhëzën me drurin e zbuluar të nënshartesës.
- të bëjë lidhjen e kalemmit të shartuar nga poshtë lart dhe lyerjen mastiç të vendit të shartimit.
- të kontrollojë zënien e shartesave pas dy javësh nga realizimi i shartimit.
- të kryejë rishartimin në rastet kur shartesat nuk kanë zënë.
- të kryejnë shërbimet e nevojshme pas shartimit.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë shartimit me syth të fjetur ose të zgjuar dhe me kalem nën lëvore.

RM 3 Nxënësi plehëron tokën në pemëtoret në prodhim.

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e veglave, pajisjeve dhe makinerive për plehërimin e tokës në pemëtore në prodhim.
- Marrja e mostrës së tokës për analiza kimike.
- Përcaktimi i llojit të plehrave organike dhe kimike.
- Përcaktimi i sasisë së plehrave organike dhe kimike.
- Përcaktimi i mjeteve për transportimin e plehut në pemëtore.
- Transportimi i sasisë së plehut në pemëtore në prodhim.
- Përcaktimi i mënyrës së plehërimit.
- Kryerja e plehërimit në pemëtore në prodhim.
- Pastrimi i vendit të punës pas plehërimit të tokës.
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e veglave, pajisjeve dhe makinerive pas plehërimit të tokës në pemëtore në prodhim.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së plehërimit të tokës në pemëtore në prodhim.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe makineritë e duhura për plehërimin e tokës në pemëtore në prodhim.
- të marrë mostra për analiza kimike të tokës
- të përcaktojë llojin e plehrave organike dhe kimike, sipas llojit të tokës së mbjellë.
- të përcaktojë sasinë e plehrave organike dhe kimike, sipas nevojave të kulturës së mbjellë.
- të përcaktojë mjetet e nevojshme për transportimin e plehut në pemëtore në prodhim.
- të transportojë sasinë e plehrave të përcaktuara në

- pemëtore në prodhim.
- të përcaktojë mënyrën e plehërimit të tokës në pemëtore, me krah ose makineri, sipas mundësive të mekanizimit.
- të kryejë plehërimin e tokës në pemtore sipas mënyrës së zgjedhur.
- të pastrojë siç duhet vendin e punës pas plehërimit të tokës në pemëtore në prodhim.
- të pastrojë dhe mirëmbajë veglat, pajisjet dhe makineritë pas plehërimit të tokës në përputhje me rregullat teknike të tyre.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe e të mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së plehërimit të tokës në pemëtore në prodhim.

RM 4 Nxënësi punon tokën në pemëtore në prodhim.

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve për punimin e tokës në pemëtore.
- Transportimi i veglave e pajisjeve në pemëtore.
- Përcaktimi i mënyrës së mbajtjes së tokës në pemtore.
- Kryerja e punimit të tokës rreth pemëve.
- Kryerja e punimit të tokës midis rreshtave të pemëve.
- Pastrimi i vendit të punës pas punimit të tokës.
- Grumbullimi, pastrimi dhe mirëmbajtja e veglave pajisjeve dhe makinerive të punimit të tokës në pemëtore në prodhim
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punimit të tokës në pemtore në prodhim.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përzgjedhë veglat dhe pajisjet për punimin e tokës në pemëtore.
- Të transportojë veglat e pajisjet në pemëtore.
- Të përcaktojë mënyrën e mbajtjes së tokës në pemtoret në prodhim (livadh ose të punuar rreth kurorës së pemës).
- Të kryejë punimin e tokës me krah rreth pemëve.
- Të kryejë punimin e tokës midis rreshtave të pemëve, me krah ose me mjete mekanike, sipas mundësive të mekanizimit të pemëtore.
- Të pastrojë vendin e punës pas punimit të tokës, sipas rregullit të caktuar.
- Të pastrojë dhe mirëmbajë veglat, pajisjet dhe makineritë e punimit të tokës në pemëtore në prodhim
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punimit të tokës në pemëtore në prodhim.

RM 5 Nxënësi ujit pemët në pemëtore.

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve për ujitjen e pemëve në pemëtore.
- Transportimi i veglave e pajisjeve në pemëtore.
- Përcaktimi i mënyrës së ujitjes së pemëve në pemëtore.
- Kryerja e ujitjes me brazda e pemëve në pemëtore.
- Kryerja e ujitjes me tava e pemëve në pemëtore.
- Kryerja e ujitjes me impiant e pemëve në pemëtore.
- Kryerja e ujitjes me pika e pemëve në pemëtore
- Kryerja e fertigimit të pemëve në pemëtore
- Grumbullimi, pastrimi dhe mirëmbajtja e veglave dhe pajisjeve të ujitjes së pemëve në pemëtore.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë ujitjes së pemëve në pemëtore në prodhim.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e nevojshme për ujitjen e pemëve në pemëtore.
- Të transportojë me kujdes veglat e pajisjet e ujitjes së pemëve në pemëtore.
- Të përcaktojë mënyrën e mënyrës e ujitjes së pemëve në pemëtore.
- Të kryejë ujitjen me brazda të pemëve në pemëtore sipas teknikës së duhur dhe nevojave të kulturës.
- Të kryejë ujitjen me tava të pemëve në pemëtore sipas teknikës së duhur dhe nevojave të kulturës.
- Të kryejë ujitjen me impiant të pemëve në pemëtore sipas teknikës së duhur dhe nevojave të kulturës.
- Të kryejë ujitjen me pika të pemëve në pemëtore sipas teknikës së duhur dhe nevojave të kulturës
- Të kryejë fertigimin e pemëve në pemëtore sipas teknikës së duhur dhe nevojave të kulturës.
- Të grumbullojë pastrojë dhe mirëmbajë veglat dhe pajisjet e ujitjes së pemëve në pemëtore në prodhim
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë ujitjes së pemëve në pemëtore në prodhim.

RM 6 Nxënësi kryen krasitjen e gjelbër të pemëve në pemëtore.

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e veglave dhe materialeve për krasitjen e gjelbër të pemëve në pemëtore.
- Përcaktimi i formës së mbajtjes së kurorës së pemëve.
- Përcaktimi i mënyrës së krasitjes së gjelbër të pemëve.
- Teknika e krasitjes së gjelbër te pemët farore.

- Teknika e krasitjes së gjelbër te pemët bërthamore.
- Pastrimi i pemëtores nga mbeturinat e krasitjes së gjelbër të pemëve.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë krasitjes së gjelbër të pemëve në pemëtores në prodhim.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përzgjedhë veglave dhe materialet e nevojshme për krasitjen e gjelbër të pemëve në pemëtores.
- Të përcaktojë formën e mbajtjes së kurorës së pemëve sipas kërkesave të kulturave.
- Të përcaktojë mënyrën e krasitjes së gjelbër të pemëve sipas kulturave.
- Të kryejë krasitjen e gjelbër te pemët farore sipas teknikës së duhur.
- Të kryejë krasitjen e gjelbër te pemët bërthamore sipas teknikës së duhur.
- Të pastrojë sipërfaqen e pemëtores nga mbeturinat e krasitjes së gjelbër të pemëve.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë krasitjes së gjelbër të pemëve në pemëtores në prodhim.

RM 7 Nxënësi spërkat pemët në pemëtores me preparate kimike të lëngshme.

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e veglave, materialeve dhe preparateve për spërkatje kimike të pemëve në pemëtores.
- Përzgjedhja e kulturës drufrutore për trajtim.
- Diagnostikimi i pemëve të prekura nga sëmundje dhe dëmtues.
- Përcaktimi i sëmundjeve dhe dëmtuesve të pemëve në pemëtores
- Përcaktimi i numrit të rrënjëve të pemëve për spërkatje.
- Përgatitja e mjetit dhe e pompës për spërkatje.
- Llogaritja e përafërt e sipërfaqes së gjelbër për çdo kurorë
- Përzgjedhja e preparatit kimik.
- Përcaktimi i sasisë së ujit dhe preparatit kimik.
- Përgatitja e preparatit të lëngshëm kimik.
- Mbushja e botit të mjetit me preparatin e lëngshëm.
- Kryerja e spërkatjes në çdo kurorë peme të prekur nga sëmundje apo dëmtues.
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e mjetit dhe e botit spërkatës pas kryerjes së spërkatjes së pemëve në pemëtores.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë spërkatjes së gjelbër të pemëve në prodhim.

së mjedisit gjatë spërkatjes me preparate kimike të lëngshme të pemëve në pemëtore në prodhim.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përzgjedhë veglat, preparatin dhe materialet e nevojshme për spërkatje kimike të pemëve në pemëtore.
- Të përcaktojë llojin e kulturës drufrutore për trajtim kimik – farore, bërthamore, ulliri, hardhia, agrume etj.
- Të diagnostikojë saktë pemët e prekura nga sëmundje dhe dëmtues në pemëtore.
- Të përcaktojë saktë sëmundjet dhe dëmtuesit e pemëve në pemëtore
- Të përcaktojë numrin e saktë për rrënjë të pemëve për spërkatje kimike.
- Të përgatisë mjetin dhe e pompës për spërkatje sipas procedurës teknike.
- Të llogarisë, siç duhet, sipërfaqen e gjelbër për çdo kurorë peme.
- Të përzgjedhë preparatin e duhur kimik sipas llojit të sëmundjes dhe dëmtuesit.
- Të përcaktojë siç duhet sasinë e ujit dhe të preparatit kimik duke respektuar raportin e përzierjes së tyre.
- Të përgatisë preparatin e lëngshëm kimik sipas raportit të përcaktuar për përzierje.
- Të mbushë botin e mjetit me preparatin e lëngshëm sipas rregullit teknik.
- Të kryerë spërkatjen në çdo kurorë peme të prekur nga sëmundje apo dëmtues sipas procedurës së punës.
- Të pastrojë dhe mirëmbajë mjetin dhe botin spërkatës pas kryerjes së spërkatjes së pemëve në pemëtore.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë spërkatjes me preparate kimike të lëngshme të pemëve në pemëtore në prodhim.

RM 8 Nxënësi kryen vjelen e kulturave drufrutore.

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e veglave, pajisjeve dhe materialeve për vjeljen e kulturave drufrutore.
- Përzgjedhja kulturës drufrutore për vjelje.
- Përcaktimi i momentit të vjeljes.
- Përcaktimi i mënyrës së vjeljes.
- Kryerja e vjeljes së kulturës drufrutore.
- Vendojsa e frutave të vjela në enët të posaçme.
- Transportimi i frutave të vjela në magazinë.
- Seleksionimi dhe standardizimi i frutave të vjela.
- Amballazhimi i prodhimit.
- Ruajtja e prodhimit në magazinë.

- Pastrimi dhe mirëmbajtja e veglave, pajisjeve, mjeteve dhe materialeve pas vjeljes së kulturave drufrutore.

–

- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë vjeljes së kulturave drufrutore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet për vjeljen e kulturave drufrutore sipas llojit të kulturës.
- Të përzgjedhë llojin e kulturës drufrutore për vjelje (farore, bërthamore, hardhia, ulliri, agrume etj).
- Të përcaktojë momentin e vjeljes sipas kohës së pjekjes së frutave dhe drejtimit të prodhimit.
- Të përcaktojë mënyrën e vjeljes sipas llojit të kulturës së përzgjedhur.
- Të kryejë vjeljen e kulturës drufrutore, me krah ose në mënyrë mekanike.
- Të vendosë me shumë kujdes frutat e vjelë në enë të posaçme sipas llojit të frutit.
- Të transportojë, me krah apo mjete mekanike, frutat e vjelë në magazinë.
- Të seleksionojë frutat e sëmurë dhe të dëmtuar dhe standardizojë frutat e shëndoshë sipas drejtimit të prodhimit.
- Të ambalazhojë prodhimin sipas kërkesës.
- Të ruajë prodhimin në magazinë sipas kërkesave të përcaktuara të ruajtjes për çdo kulturë drufrutore.
- Të pastrojë dhe mirëmbajë veglat, pajisjet, mjetet dhe materialet pas vjeljes së kulturave drufrutore.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë vjeljes së kulturave drufrutore.

RM 9 Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta ekonomike të teknologjisë së prodhimit të kulturave drufrutore.

Përmbajtja:

- Kostot e teknologjisë së prodhimit në kulturat drufrutore, si dhe përbërësit e kostove.
- Preventivi i materialeve, kostoja për materialet.
- Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.).
- Kosto të tjera (transport dhe makineri).
- Të ardhurat, fitimi, llogaritja e fitimit në një biznes të vogël të teknologjisë së prodhimit në kulturat drufrutore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jenë të aftë:

- të njehsojë kostot e piktimit dhe të shërbimeve që kryhen në kulturat drufrutore, sipas llojit të shërbimit.
- të njehsojë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojë kostot e tjera (transport dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogarisë të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për teknologjinë e prodhimit në kulturat drufrutore.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul mund të trajtohet në bazën prodhuese të shkollës ose në pemëtore, ullishte, vreshta dhe agrumishte sipas mundësive që ofron zona dhe rajoni ku ndodhet shkolla.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të përgatitjes për punë, të piktimit, të shartimit me syth të fjetur ose të zgjuar, të shartimit me kalem nën lëvore, të shërbimeve agroteknike në kulturat drufrutore, si dhe llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me piktimet, shartimet dhe shërbimet agroteknike të kryera tek kulturat drufrutore.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune të përgatitjes për punë, të hartimit të skicës së piktimit, të zbatimit të piktimit, shartimeve me syth dhe kalem nën lëvore, të shërbimeve agroteknike si plehrime, punime, krasitje dimërore e verore, ujitje, vjelje etj si dhe llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me teknologjinë e prodhimit të kulturave drufrutore.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve dhe materialeve për piktimit, shartime e shërbime agroteknike të kulturave drufrutore.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit gjatë piktimit, shartimeve e shërbimeve të ndryshme agroteknike.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përgatitjes për punë, piktimit, shartimeve, shërbimeve agroteknike, si dhe llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me to.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Baza prodhuese e shkollës (pemëtore, vreshtari, ullishte apo agrumishte)
 - Zhallonë
 - Metër shirit, tela piktimit ose spango, piketa, nivelë uji etj.
 - Thika shartimi
 - Gërshërë krasitëse, sharrë, shkallë, gur grihe, furça, kova, përzierës për përgatitjen e mastiçit.
-

-
- Rrafje
 - Mastiç shartimi
 - Bela, lopata etj
 - Impjant e mjete të tjera për ujitje.
 - Etiketa
 - Arka, shporta, rërë etj.
 - Plehra kimike, plehra organike, pesticide
 - Pajisje kancelarie.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e teknologjisë të prodhimit të kulturave drufrutore (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

2. Moduli “Përdorimi i preparateve kimike te kulturat e fermës”

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Ferma bujqësore dhe blegtorale
Niveli: II
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PËRDORIMI I PREPARATEVE KIMIKE TE KULTURAT E FERMËS	M-14-515-10
Qëllimi i modulit	Modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi praktike për përgatitjen e tretësirave të pesticideve dhe kryerjen e trajtimeve kimiken te kulturat bujqësore në fermë.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të kualifikimit në drejtimin mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi kryen procese pune përgatitore për përdorimin e pesticideve. Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none">– Lajmërimi i fermerëve të tjerë kufitare për trajtimin kimik.– Zbatimi i rregullave për ruajtjen e shëndetit të njerëzve dhe kafshëve.– Përgatitja e uniformës të përshtatshme për punë.– Zgjedhja e paisjeve të nevojshme për përgatitjen e solucionëve dhe kryerjen e trajtimit kimik.– Përgatitja e mjeteve mbrojtëse ndaj pesticideve.– Përcaktimi i radhës së punës për përdorimin e pesticideve.– Përcaktimi i vendit për përgatitjen e solucionëve.– Përcaktimi i objektit për trajtim me pesticide.– Përcaktimi i kulturës për trajtim me pesticide.– Zgjedhja e preparatit.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë trajtimeve kimike. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli Kriteret e vlerësimit: <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– Të lajmërojë fermerët e tjerë kufitare më to, për datën e trajtimit dhe llojin e helmit që do të përdoret– Të zbatojë rregullat e ruajtjes së shëndetit të njerëzve dhe kafshëve nga përdorimi i helmeve.	

-
- Të përgatisë uniformën e duhur për të kryer trajtime kimike.
 - Të zgjedhë pajisjet e duhura për përgatitjen e solucionëve dhe kryerjen e trajtimit kimik.
 - Të përgatisë siç duhet mjetet mbrojtëse ndaj pesticideve.
 - Të përcaktojë saktë radhën e punës për përdorimin e pesticideve.
 - Të përcaktojë vendin për përgatitjen e solucionëve sipas kritereve të kërkuara.
 - Të përcaktojë objektin për trajtim me pesticide, dëmtues, sëmundje.
 - Të përcaktojë kulturën e sëmurë apo të prekur nga dëmtues, për trajtim me pesticide.
 - Të përzgjedhë preparatin sipas llojit të sëmundjes apo dëmtuesit.
 - Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë trajtimeve kimike.

RM 2 Nxënësi përgatit tretësirën për trajtim.

Përmbajtja:

- Veshja e kompletit të punës dhe maskës mbrojtëse.
- Llogaritja e sasisë së preparatit.
- Llogaritja e sasisë së ujit për përgatitjen e tretësirës.
- Peshimi i sasisë së preparatit.
- Matja e sasisë së ujit.
- Përzierja e preparatit me masën e ujit.
- Përgatitja e tretësirës homogjene.
- Zbatimi i rregullave për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe kafshëve.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së tretësirës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të veshë kompletin e punës dhe maskës mbrojtëse para fillimit të përgatitjes së tretësirës.
- Të llogarisë sasisë e duhur të preparatit për përgatitjen e tretësirës.
- Të llogarisë sasisë e ujit për përgatitjen e tretësirës.
- Të peshojë saktë sasinë e preparatit sipas llogaritjeve të bëra.
- Të matë sasinë e ujit sipas raportit të kërkuar për përgatitjen e tretësirës.
- Të kryejë përzierjen e preparatit me masën e ujit.
- Të përgatisë tretësirën homogjene sipas kërkesave të duhura.
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes së shëndetit të njerëzve

dhe kafshëve gjatë përgatitjes së tretësirës.

- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së tretësirës.

RM 3 Nxënësi trajton kimikisht bimët e infektuara.

Përmbajtja:

- Kontrolli i faktorëve klimatik.
- Kryerja e trajtimit kimik në bimët e infektuara.
- Vendosja e tabelave lajmëruese për rrezik nga helmi .
- Pastrimi i mjeteve të punës.
- Vendosja e uniformës dhe mjeteve mbrojtëse në vendin e caktuar.
- Zbatimi i rregullave të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe kafshëve.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë trajtimit kimik të bimëve të infektuara.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të kontrollojë faktorët klimatik si temperatura, lagështira, era etj.
- Të kryejë trajtimin kimik në bimët e infektuara sipas llojit të sëmundjes.
- Të vendosë tabelat lajmëruese për rrezik nga helmi .
- Të pastrojë siç duhet mjetet e punës.
- Të vendosë uniformën dhe mjetet mbrojtëse në vendin e caktuar.
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe kafshëve gjatë kryerjes së trajtimit kimik të bimëve.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë trajtimit kimik të bimëve të infektuara.

RM 4 Nxënësi verifikon rezultatin e cilësisë së trajtimit kimik.

Përmbajtja:

- Përcaktimi i mënyrës së sondazhit.
- Vrojtimi i cilësisë së trajtimit.
- Të mbajë shënim rezultatet e vrojtimit të cilësisë.
- Të analizojë rezultatet e vrojtimit.
- Të nxjerrë rezultatin sipas situatës së ndodhur.
- Të verifikojë rezultatin e nxjerrë me atë standard.
- Të respektojë rregullat e mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe kafshëve gjatë verifikimit të rezultatit të trajtimit të kulturave drufrutore.
- Kryerja e llogaritjeve të thjeshta ekonomike të përdorimit të preparateve kimike në kulturat bujqësore.
- Kostot e kryerjes së trajtimeve kimike në kulturat bujqësore, si dhe përbërësit e kostove.

- Preventivi i materialeve, kostoja për materialet.
- Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.).
- Kosto të tjera (transport dhe makineri).
- Të ardhurat dhe llogaritja e fitimit në një biznes të vogël për përdorimin e preparateve kimike në kulturat bujqësore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë mënyrën më efektive të sondazhit.
- të vrojtojë cilësinë e trajtimit të kulturave.
- të shënojë saktë rezultatet e kontrollit.
- të analizojë rezultateve e kontrollit.
- të nxjerrë saktë rezultatin e kontrollit.
- të verifikojë rezultatit e nxjerrë me rezultatit standard.
- të respektojë rregullat e mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe kafshëve gjatë vërtetimit dhe verifikimit të rezultatit të trajtimit të kulturave drufrutore.
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike të përdorimit të preparateve kimike në kulturat bujqësore.
 - të njehsojë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
 - të njehsojë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
 - të njehsojë koston e tjera (transport dhe makineri), sipas manualit përkatës.
 - të llogarisë të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për përdorimin e preparateve kimike në kulturat bujqësore.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul mund të trajtohet në fermën e shkollës ose në ferma të tjera pranë shkollës sipas mundësive që ofron zona dhe rajoni ku ndodhet ajo.
- Gjatë trajtimit të modulit mësuesi i praktikës duhet të përdorë demonstrime konkrete të kryerjes së proceseve të punës gjatë përdorimit të preparateve kimike në kulturat bujqësore si: përgatitja për punë, përgatitja e tretësirës, kryerja e trajtimit, kontrolli i cilësisë së trajtimit, si dhe llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me këto procese pune.
- Nxënësit duhet të praktikohen sa më shumë të jetë mundur në përgatitjen për punë, përgatitjen e tretësirës, kryerjen e trajtimit, kontrollit të cilësisë së trajtimit, si dhe llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me këto procese pune.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve dhe materialeve për kryerjen e trajtimeve kimike në kulturat bujqësore.
- Mësuesi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë

kryerjes së trajtimeve kimike në kulturat bujqësore.

- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përgatitjes për punë, përgatitjes së tretësirës, kryerjes së trajtimit, kontrollit të cilësisë së trajtimit, si dhe llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me këto procese pune.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Ferma e shkollës
 - Pesticide të ndryshme Mjete të tjeshhta pune krahu dhe të mekanizuara për kryerjen e trajtimeve kimike.
 - Kova e mjete spërkatëse.
 - Mjete transporti.
 - Pankarta, udhëzues, katalogë, rregullore, standarde industriale etj.
 - Pajisje kancelarie.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e shërbimeve që lidhet me përdorimin e preparateve kimike në kulturat bujqësore (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

3. Moduli “Ngritja e rrjetit kullues në fermë”

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Ferma bujqësore dhe blegtorale
Niveli: II
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	NGRITJA E RRJETIT KULLUES NË FERMË	M-14-516-10
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit në hapjen e kanaleve kulluese të para (K ₁ K), të dyta (K ₂ K) dhe të treta (K ₃ K).	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të kualifikimit në drejtimin mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi kryen procese pune përgatitore për hapjen e kanaleve kulluese.</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">– Njohje me rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë hapjes së kanaleve kulluese.– Përzgjedhja e ngastrës ku do të hapen kanalet kulluese.– Përzgjedhja e veglave dhe mjeteve të punës për hapjen e kanaleve kulluese.– Transporti i bazës materiale që do të përdoret.– Përcaktimi i distancës dhe thellësisë së kanaleve kulluese.– Pastrimi i ngastrës për hapjen e kanaleve kulluese.– Skicimi dhe interpretimi i skicës së hapjes së kanaleve kulluese. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Pyetje-përgjigje me gojë.– Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të theksojnë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë hapjes e kanaleve kulluese të para (K₁K), të dyta (K₂K) dhe të treta (K₃K).– të përzgjedhin ngastrën për hapjen e kanaleve kulluese të para (K₁K), të dyta (K₂K) dhe të treta (K₃K), sipas llojit të tokës.– të përzgjedhin veglat dhe mjetet e duhura të punës (bel, lopatë, kazëm, zhalon, metër, kompas, spango etj.).– të transportojnë bazën materiale të punës për hapjen e kanaleve kulluese të para (K₁K), të dyta (K₂K) dhe të treta	

- (K₃K) sipas kërkesave teknike.
- të përcaktojnë distancat, pjerrësinë dhe thellësitë e kanalit sipas relievit dhe tipit të kanalit kullues.
- të pastrojnë ngastrën nga mbetjet inerte dhe papastërtitë e tjera për hapjen e kanaleve kulluese të para (K₁K), të dyta (K₂K) dhe të treta (K₃K).
- të skicojnë dhe interpretojnë skica për hapjen e kanaleve kulluese të para (K₁K), të dyta (K₂K) dhe të treta (K₃K).

RM 2 Nxënësit hapin kanalën e parë kullues (K₁K).

Përmbajtja:

- Përcaktimi i vendit në terren ku do të hapet kanali i parë kullues (K₁K).
- Përcaktimi i përmasave të kanalit të parë kullues (K₁K).
- Piketimi i kanalit të parë kullues (K₁K) që do të hapet.
- Hapja e kanalit të parë kullues (K₁K) në formë trapezi.
- Sistemimi i dheut të hedhur pas hapjes së kanalit.
- Kontolli i cilësisë së hapjes.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë hapjes së kanalit të parë kullues (K₁K).

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të përcaktojnë vendin në terren ku do të hapet kanali i parë kullues (K₁K) në kuotën më të ulët sipas një norme të caktuar kullimi.
- të përcaktojnë përmasat e kanalit të parë kullues (K₁K) sipas relievit, përbërjes mekanike të tokës, rreshjeve, rrjetit të përrenjve dhe vendit të derdhjes së tyre.
- të piketojnë kanalën e parë kullues (K₁K) sipas përmasave të përcaktuara dhe kushteve teknike.
- të hapin kanalën e parë kullues (K₁K) në formë trapezi sipas parametrave hidraulikë (thellësi 2-4 m, largësi midis kanaleve 1000-1600 m dhe pjerrësi e shtratit sipas terrenit).
- të sistemojnë dheun e hedhur pas hapjes së kanalit sipas terrenit.
- të kontrollojnë cilësinë e hapjes së kanalit të parë kullues (K₁K) për plotësimin e kushteve teknike.
- të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë hapjes së kanalit të parë kullues (K₁K).

RM 3 Nxënësit hapin kanalën e dytë kullues (K₂K).

Përmbajtja:

- Përcaktimi i vendit në bllok ku do të hapet kanali i dytë kullues (K₂K).
- Përcaktimi i përmasave të kanalit të dytë kullues (K₂K).
- Piketimi i kanalit të dytë kullues (K₂K) që do të hapet.

- Hapja e kanalit të dytë kullues (K_2K) në formë trapezi.
- Sistemimi i dheut të hedhur pas hapjes së kanalit.
- Kontrolli i cilësisë së hapjes.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë hapjes së kanalit të dytë kullues (K_2K).

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të përcaktojnë vendin në bllok ku do të hapet kanali i dytë kullues (K_2K) në pozicionin pingul me kanalin e parë kullues (K_1K).
- të përcaktojnë përmasat e kanalit të dytë kullues (K_2K) me kuotë të tabanit 0,5 m më lart se tabani i kanalit të parë kullues (K_1K).
- të piketojnë kanalin e dytë kullues (K_2K) sipas përmasave të përcaktuara dhe kushteve teknike.
- të hapin kanalin e dytë kullues (K_2K) në formë trapezi sipas parametrave hidraulikë (thellësi 1,8-3 m, largësi midis kanaleve 500-800 m, me bazë të vogël 0,5m dhe koeficient të shpatinës 1).
- të sistemojnë dheun e hedhur pas hapjes së kanalit sipas terrenit.
- të kontrollojnë cilësinë e hapjes së kanalit të dytë kullues (K_2K) për plotësimin e kushteve teknike.
- të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë hapjes së kanalit të dytë kullues (K_2K).

RM 4 Nxënësit hapin kanalin e tretë kullues (K_3K).

Përmbajtja:

- Përcaktimi i vendit në ngastër ku do të hapet kanali i tretë kullues (K_3K).
- Përcaktimi i përmasave të kanalit të tretë kullues (K_3K).
- Piketimi i kanalit të tretë kullues (K_3K) që do të hapet.
- Hapja e kanalit të tretë kullues (K_3K) në formë trapezi.
- Sistemimi i dheut të hedhur pas hapjes së kanalit.
- Kontrolli i cilësisë së hapjes.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë hapjes së kanalit të tretë kullues (K_3K).

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të përcaktojnë vendin në ngastër ku do të hapet kanali i tretë kullues (K_3K) në pozicionin pingul me kanalin e dytë kullues (K_2K).
- të përcaktojnë përmasat e kanalit të tretë kullues (K_3K) me kuotë të tabanit 0,5m më lart se tabani i kanalit të dytë kullues (K_2K).

- të piketojnë kanalin e tretë kullues (K₃K) sipas përmasave të përcaktuara dhe kushteve teknike.
- të hapin kanalin e tretë kullues (K₃K) në formë trapezi sipas parametrave hidraulikë (thellësi 1,2-2m, largësi midis kanaleve 150-200m, me bazë të vogël 0,3m dhe koeficient të shpatinës 1).
- të sistemojnë dheun e hedhur pas hapjes së kanalit sipas terrenit.
- të kontrollojnë cilësinë e hapjes së kanalit të tretë kullues (K₃K) për plotësimin e kushteve teknike.
- të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë hapjes së kanalit të tretë kullues (K₃K).

RM 5 Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta ekonomike për ngritjen e rrjetit kullues në fermë.

Përmbajtja:

- Kostot për hapjen e kanaleve kulluese, si dhe përbërësit e kostove.
- Preventivi i materialeve, kostoja për materialet.
- Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.).
- Kosto të tjera (transport dhe makineri).
- Krahasimi i kostos së hapjes së kanalit me krahë dhe me makineri
- Të ardhurat, fitimi, llogaritja e fitimit në një biznes të vogël për hapjen e kanaleve kulluese.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të njehsojnë kostot e hapjes së kanaleve kulluese, si dhe përbërësit e kostove, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë kostot e tjera (transport dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të krahasojnë kostot e hapjes së kanalit me krahë dhe me makineri.
- të llogaritin të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për hapjen e kanaleve kulluese.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në terren.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të proceseve për hapjen e kanaleve kulluese.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve për hapjen e kanaleve kulluese.
- Nxënësit duhet të përfshihen në veprimtari konkrete për

kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike për hapjen e kanaleve kulluese.

- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve dhe makinerive për hapjen e kanaleve kulluese.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së veglave dhe pajisjeve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për hapjen e kanaleve kulluese si dhe për llogaritje të thjeshta ekonomike.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen terreni, veglat dhe pajisjet e punës të mëposhtme:

- Skica të gatshme për rrjetin e kanaleve kulluese
 - Bel, lopatë, kazëm, zhalon, metër-shirit, spango etj.
 - Pajisje kancelarie.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e hapjes së kanaleve kulluese (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

4. Moduli “Sistemimi i tokës bujqësore“

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Ferma bujqësore dhe blegtorale
Niveli: II
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	SISTEMIMI I TOKËS BUJQËSORE	M-14-517-10
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer sistemimin sipërfaqësor në formë kurrizi brazdëmyllur e brazdëhapur, sistemimin e rrafshët të tokave si dhe në llogaritjet e thjeshta ekonomike që lidhen me to.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësit kryejnë punime përgatitore për sistemimin e tokave. Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none">– Përzgjedhja e ngastrës për sistemim.– Përzgjedhja e mjeteve dhe makinerisë së punës (traktor) për sistemimin e tokës.– Përgatitja e ngastrës për sistemim.– Transporti i mjeteve dhe makinerisë së punës.– Interpretimi i skicës së gatshme për lëvizjen e plugut.– Skicimi i lëvizjes së plugut.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit për sistemimin e tokave. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">– Pyetje – përgjigje me gojë.– Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit: <p>Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përzgjedhin ngastrën për sistemim sipas përbërjes mekanike të tokës.– të përzgjedhin mjetet e duhura të punës (zhalon, metër, kompas, spango etj.) dhe makinerinë (traktor me plug)– të përcaktojnë gjerësinë e lehut sipas parametrave teknike për kullim dhe ujitje më të mirë.– të përgatisin ngastrën për sistemim sipas kërkesave teknike.– të transportojnë mjetet dhe makinerinë e punës sipas kërkesave teknike.	

- të interpretojnë skica të gatshme për lëvizjen e plugut.
- të skicojnë lëvizjen e plugut sipas skemës së dhënë.
- të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë sistemimit të tokave bujqësore.

RM 2 Nxënësit kryejnë sistemimin sipërfaqësor në formë kurrizi.

Përmbajtja:

- Përcaktimi i koeficientit të shkrifërimit të tokës.
- Përcaktimi i gjerësisë dhe pjerrësisë së lehut.
- Ndarja e ngastrës në lehe.
- Hapja e vijave kulluese paralele me K₂K.
- Montimi i plugut te traktori.
- Lëvizja e traktorit me plug në ngastër.
- Regjistrimi i thellësisë fillestare të plugimit.
- Përcaktimi i ndryshimit të thellësisë së plugimit gjatë kalimeve të plugut.
- Kryerja e procesit të ndërtimit të kurrizit.
- Kontrolli i cilësisë së ndërtimit të kurrizit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë sistemimit në formë kurrizi.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të përcaktojnë koeficientin e shkrifërimit sipas llojit të tokës.
- të përcaktojnë gjerësinë dhe pjerrësinë e lehut sipas parametrave teknikë për kullim dhe ujitje më të mirë dhe llojit të tokave.
- të ndajnë ngastrën në lehe duke respektuar përmasat e ngastrës.
- të hapin vijat kulluese paralele me K₂K në largësinë 20-30m.
- të montojnë plugun te traktori sipas kushteve teknike.
- të lëvizin traktorin me plug duke respektuar drejtimin e leheve.
- të regjistrojnë thellësinë fillestare të plugimit (0,5m) sipas kushteve teknike.
- të përcaktojnë ndryshimin e thellësisë së punës së traktorit për të dhënë formën e kurrizit sipas parametrave teknikë në varësi të llojit të tokës.
- të kryejnë procesin e ndërtimit të kurrizit sipas parametrave teknikë në varësi të llojit të tokës.
- të kontrollojnë cilësinë e ndërtimit të kurrizit për plotësimin e kushteve teknike.
- të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë sistemimit sipërfaqësor në formë kurrizi.

RM 3 Nxënësit kryejnë punime për ruajtjen e kurrizit me mënyrat brazdëmbyllur dhe brazdëhapur.

Përmbajtja:

- Përcaktimi i kohës së kryerjes së punimeve brazdëmbyllur dhe brazdëhapur.
- Kryerja e punimit brazdëmbyllur.
- Kryerja e punimit brazdëhapur.
- Kontrolli i cilësisë së punimit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik për ruajtjen e kurrizit me mënyrat brazdëmbyllur dhe brazdëhapur.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të përcaktojnë kohën e kryerjes së punimeve brazdëmbyllur në vjeshtë dhe brazdëhapur në pranverë .
- të kryejnë punimin brazdëmbyllur, duke ruajtur gjerësinë kapëse, thellësinë e plugimit dhe shpejtësinë e njëtrajtshme të lëvizjes për një kullim më të mirë sipas skemës së dhënë.
- të kryejnë punimin brazdëhapur për të krijuar një brazdë të hapur në mesin e lehut që do të shërbejë për ujitje duke ruajtur gjerësinë kapëse, thellësinë e plugimit dhe shpejtësinë e njëtrajtshme të lëvizjes sipas skemës së dhënë.
- të kontrollojnë cilësinë e punimit për plotësimin e kushteve teknike.
- të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë punës për ruajtjen e kurrizit me mënyrat brazdëmbyllur dhe brazdëhapur.

RM 4 Nxënësit kryejnë punime për sistemimin e rrafshët të tokës.

Përmbajtja:

- Përcaktimi i ngastrës ku do të kryhet sistemimi i rrafshët i tokës.
- Ndarja e ngastrës në lehe.
- Montimi i plugut te traktori.
- Lëvizja e traktorit me plug në ngastër.
- Regjistrimi i thellësisë fillestare të plugimit.
- Kryerja e procesit të sistemimit të rrafshët.
- Kontrolli i cilësisë së sistemimit të rrafshët.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë sistemimit të rrafshët.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të përcaktojnë ngastrën ku do të kryhet sistemimi i rrafshët sipas tipit të tokës.
- të ndajnë ngastrën në lehe sipas përmasave të përcaktuara.
- të montojnë plugun në traktor sipas kushteve teknike.
- të kryejnë procesin e sistemimit të rrafshët me traktor duke zbatuar skemën sipas rregullave për ruajtjen e thellësisë së njëtrajtshme, gjerësinë e njëjtë të punimit dhe lëvizjen e njëtrajtshme të traktorit.
- të kontrollojnë cilësinë për plotësimin e parametrave teknikë.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë sistemimit të rrafshët të tokës.

RM 5 Nxënësit kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike për sistemimin e tokave bujqësore.

Përmbajtja:

- Kostot për sistemimin e tokave bujqësore.
- Preventivi i materialeve, kostoja për materialet.
- Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.).
- Kosto të tjera (transport dhe makineri).
- Të ardhurat, fitimi, llogaritja e fitimit në një biznes të vogël për sistemimin e tokave bujqësore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të njehsojnë kostot për sistemimin e tokave bujqësore.
- të njehsojnë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë kostot e tjera (transport dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogaritin të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për sistemimin e tokave bujqësore.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në ngastra të tokës bujqësore.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të proceseve për sistemimin e tokave bujqësore.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve për sistemimin e tokave bujqësore.
- Nxënësit duhet të përfshihen në veprimtari konkrete për kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike për sistemimin e tokave bujqësore.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve dhe makinerive për sistemimin

e tokave bujqësore.

- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së makinerisë dhe pajisjeve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për sistemimin e tokave bujqësore si dhe për llogaritje të thjeshta ekonomike.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohet ngastra e tokës bujqësore, veglat, pajisjet, dhe makineria e mëposhtme:

- Ngastër toke.
 - Traktor me plug
 - Vegla dhe pajisje pune për sistemimin e tokave bujqësore.
 - Pankarta, skica, udhëzues, katalogë, rregullore, etj.
 - Pajisje kancelarie.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manualët e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e sistemimit të tokave bujqësore (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

5. Moduli “Përpunimi i produkteve bujqësore e blegtorale të fermës”

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Ferma bujqësore dhe blegtorale
Niveli: II
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PËRPUNIMI I PRODUKTEVE BUJQËSORE E BLEGTORALE TË FERMËS	M-08-518-10
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer përpunimin e frutave, drithrave, perimeve, qumështit, mishit si dhe për të kryer llogaritje të thjeshta ekonomike të përpunimit të tyre.	
Kohëzgjatja e modulit	84 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi përpunon frutat. Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">– Veshja e kompletit të punës për përpunimin e frutave.– Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për përpunimin e frutave.– Dezinfektimi i enëve dhe mjedisit të punës ku do të përpunohen frutat.– Përzgjedhja e llojit të frutave për përpunim.– Përcaktimi i sasisë së frutave për përpunim.– Përcaktimi i sasisë së sheqerit.– Transporti i frutave dhe i sheqerit në repart.– Përgatitja e enëve ambalazhuese të produkteve.– Përgatitja e etiketave për ambalazhim.– Seleksionimi i frutave për përpunim.– Larja e frutave.– Përpunimi i frutave.– Ambalazhimi i produktit.– Etiketimi i produktit të ambalazhuar.– Larja dhe pastrimi i enëve e mjeteve të tjera.– Pastrimi i vendit të punës pas përpunimit të frutave.– Grumbullimi dhe transporthimi i mbeturinave.– Zbatimi i rregullave e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë përpunimit të frutave. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Pyetje – përgjigje me gojë.– Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p>	

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë kompletit e punës për përpunimin e frutave.
- të përgatitë vendit dhe mjetet e punës për përpunimin e frutave, sipas kërkesave të përcaktuara.
- të dezinfektojë enët dhe mjedisin e punës, në përputhje me kërkesat.
- të përzgjedhë llojin e frutave për përpunim, të tilla si: mollë, dardhë, pjeshkë, qershi, luleshtrydhe etj.
- të përcaktojë sasisë e frutave për përpunim, sipas kërkesës.
- të përcaktojë sasisë e sheqerit që do të përdoret në përpunimin e frutave.
- të transportojë me kujdes sasinë e frutave dhe të sheqerit në repart.
- të përgatitë enët ambalazhuese të produkteve, sipas kërkesës.
- të përgatitë etiketat për ambalazhim me të gjitha të dhënat e duhura.
- të seleksionojë frutat për përpunim, sipas kritereve dhe drejtimit të prodhimit.
- të lajë frutat me ujë të rrjedhshëm.
- të përpunojë frutat për lëng, komposto, reçel etj., sipas kërkesës.
- të përgatitë ambalazhin e duhur për mbushjen me produktin e përpunuar, sipas sasisë, kërkesave dhe standardeve për ruajtje.
- të etiketojë produktin e ambalazhuar sipas rregullit.
- të lajë dhe pastrojë enët dhe mjetet tjera të përdorura gjatë përpunimit të frutave.
- të pastrojë vendin e punës pas përpunimit të frutave, sipas kërkesave higjeno-sanitare.
- të grumbullojë dhe transportojë mbeturinat e ndryshme me mjetet e duhura dhe në vendin e caktuar.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përpunimit të frutave.

RM 2 Nxënësi përpunon drithërat.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës për pranimin e drithrave.
- Përgatitja e mjeteve të punës për përpunimin e drithrave.
- Pastrimi i drithërave për përpunim.
- Transportimi i mbeturinave të pastrimit të drithërave.
- Transportimi i drithrave për bluarje.
- Përpunimi i drithrave për miell.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë përpunimit të drithërave për miell.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë vendin e punës për pranimin e drithrave.
- të përgatitë mjetet e nevojshme të punës për përpunimin e drithrave.
- të pastrojë drithërat për përpunim, sipas metodave të caktuara.
- të transportojë në vendin e duhur mbeturinat e pastrimit të drithërave.
- të transportojë sasinë e drithrave për bluarje.
- të përpunojë drithrat për miell sipas procedurës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë gjatë përpunimit të drithërave për miell.

RM 3 Nxënësi përpunon perimet.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për përpunimin e perimeve.
- Dezinfektimi i enëve dhe mjedisit e punës.
- Transportimi i perimeve në repart.
- Seleksionimi i perimeve për prodhimin e marinadave e turshive.
- Larja e perimeve.
- Heqja e pjesëve të padobishme të perimeve.
- Përmasimi i perimeve.
- Blanshirimi i perimeve.
- Transporti i lëndëve ndihmëse në repart.
- Përgatitja e solucionit të kripës dhe acidit organik.
- Përgatitja e ambalazhit për mbushje.
- Etiketimi i ambalazheve.
- Vendosja në kutitë e ambalazhit.
- Transporti i produktit në magazinë.
- Transportimi i mbeturinave të ndryshme.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për prodhimin e marinadave dhe turshive sipas procedurave standarde.
- të dezinfektojë enët dhe mjedisin e punës sipas kërkesave higjeno-sanitare.
- të transportojë me kujdes e pa i dëmtuar perimet në repart.
- të seleksionojë me kujdes perimet për prodhimin e marinadave dhe turshive.
- të lajë perimet me ujë të rrjedhshëm.
- të heqë pjesët e padobishme të perimeve.

- të përmasojë perimet.
- të blanshirojë perimet sipas kërkesave teknologjike të procesit.
- të transportojë lëndët ndihmëse në reparat.
- të përgatisë solucionin e kripës dhe acidit organik në raportet e duhura.
- të grumbullojë e transportojë mbeturinat e ndryshme nga reparti.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë përpunimit të perimeve për marinadë e turshi.

RM 4 Nxënësi përpunon qumështin për konsum dhe nënprodukte.

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e mjeteve të punës për përpunimin e qumështit.
- Higjienizimi i mjeteve dhe i vendit të punës për përpunimin e qumështit
- Kontrollimi i treguesve cilësorë të qumështit për konsum.
- Kontrollimi i treguesve cilësorë të qumështit për nënprodukte.
- Transportimi i qumështit në rezervuarin (tankun) e grumbullimit.
- Filtrimi i sasisë së qumështit.
- Përpunimi i qumështit për konsum.
- Ambalazhimi i qumështit për konsum e ruajtje.
- Përpunimi i qumështit për nënprodukte.
- Formimi dhe kriposja e djathit.
- Ambalazhimi i nënprodukteve për konsum dhe ruajtje, të prodhuara nga përpunimi i qumështit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë përpunimit të qumështit për konsum dhe nënprodukte.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje
- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përzgjedhë mjetet e nevojshme të punës për përpunimin e qumështit për konsum dhe për nënprodukte.
- Të higjienizojë mjetet dhe i vendin e punës për përpunimin e qumështit për konsum dhe nënprodukte, sipas kushteve higjieno-sanitare.
- Të kontrollojë siç duhet, treguesit cilësorë të qumështit për konsum.
- Të kontrollojë siç duhet, treguesit cilësorë të qumështit për nënprodukte.
- Të transportojë me shumë kujdes, qumështin në

- rezervuarin (tankun) e grumbullimit.
- Të filtrojë sasisë e qumështit sipas procedurës së filtrimit.
- Të realizojë përpunimin e qumështit për konsum sipas procedurës së përpunimit.
- Të bëjë ambalazhimin e qumështit për konsum dhe ruajtje, sipas kërkesës.
- Të përpunojë qumështin për nënprodukte (kos, gjizë, gjalpë, etj) sipas procedurave përkatëse.
- të formojë dhe kripos djathin sipas procedurës përkatëse.
- Të ambalazhojë nënproduktet për konsum dhe ruajtje, të prodhuara nga përpunimi i qumështit.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë përpunimit të qumështit për konsum dhe nënprodukte.

RM 5 Nxënësi përpunon mishin për konsum.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të pranimi të shpendëve e kafshëve.
- Higjienizimi i mjeteve dhe i vendit të punës.
- Larja dhe transporti i shpendëve dhe i kafshëve në vendin e therjes.
- Therja e shpendëve dhe e kafshëve të ndryshme.
- Transportimi i mishit në vendin e përpunimit.
- Varja e shpendëve dhe e kafshëve në konvejer.
- Larja e dezinfektimi i koshave bosh të transportimit të kafshëve.
- Varja e kafshëve.
- Largimi i pjesëve të padobishme nga procesi i therjes.
- Kryerja e tualetit të kafshës pas therjes.
- Ndarja anatomike e kafshëve.
- Ambalazhimi i mishit trup.
- Ambalazhimi i mishit të ndarë në mënyrë anatomike
- Sistemimi i mishit të therur në repartet e përpunimit termik të ngrirjes.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë procesit të përpunimit të mishit të kafshëve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e pranimi të shpendëve e kafshëve.
- të higjienizojë mjetet e punës sipas rregullave higjieno-sanitare.
- të lajë kafshët dhe shpendët dhe t'i transportojë ato në vendin e therjes.
- të therë shpendë ose kafshë të tjera sipas procedurës së kryerjes.
- të transportojë mishin trup në vendin e përpunimit me

- shumë kujdes.
- të varë siç duhet shendët apo kafshët në konvejer.
 - të lajë dhe të dezinfektojë koshat bosh të transportimit të mishit trup të shendëve e të kafshëve.
 - të varë kafshët e shpendët pas larjes.
 - të largojë pjesët e padobishme nga procesi i therjes.
 - të kryejë tualetin e shpendëve dhe të kafshëve pas therjes, sipas procedurës.
 - të kryejë ndarjen anatomike të shpendëve e të kafshëve sipas llojit.
 - të ambalazhojë mishin trup të shpendëve.
 - të ambalazhojë mishin të ndarë në mënyrë anatomike të shendëve e kafshëve të ndryshme.
 - të sistemojë mishin e therur të shpendëve e të kafshëve në repartet e përpunimit termik të ngrirjes.
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë procesit të përpunimit të mishit për konsum.

RM 6 Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta ekonomike për përpunimin e produkteve bujqësore e blegtorale.

Përmbajtja:

- Kostot e përpunimit të produkteve bujqësore e blegtorale, si dhe përbërësit e kostove.
- Preventivi i materialeve, kostoja për materialet.
- Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.).
- Kosto të tjera (transport dhe makineri).
- Të ardhurat, fitimi, llogaritja e fitimit në një biznes të vogël për përpunimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të njehsojnë kostot e përpunimit të produkteve bujqësore e blegtorale, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë kostot e tjera (transport dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogaritin të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për përpunimin e produkteve bujqësore e blegtorale.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në reparte të përpunimit të frutave, perimeve dhe produkteve blegtorale.
- Instruktori i praktikës, ose teknologu i repartit duhet të përdorë

sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të proceseve përgatitore për prodhimin nënprodukteve bujqësore e blegtorale, si dhe ambalazhimin e tyre.

- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore për prodhimin e nënprodukteve bujqësore e blegtorale, si dhe ambalazhimin e tyre.
- Nxënësit duhet të përfshihen në veprimtari konkrete për kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike për prodhimin e nënprodukteve bujqësore e blegtorale, si dhe ambalazhimin e tyre.
- Instruktori i praktikës ose teknologu i repartit duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve dhe materialeve për përpunimin e produkteve bujqësore e blegtorale.
- Instruktori i praktikës ose teknologu i repartit duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së makinerive dhe pajisjeve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për prodhimin e nënprodukteve bujqësore e blegtorale si dhe ambalazhimin e tyre.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Repart për prodhimin e lëngut, kompostos, reçelit, marmelatës e prevedesë.
 - Repart për përpunimin e produkteve blegtorale
 - Mjete pune për prodhimin e lëngut, kompostos, reçelit, marmelatës e prevedesë, si dhe ambalazhimin e tyre.
 - Mjete pune për përpunimin e produkteve blegtorale
 - lëndë të para dhe ndihmëse për prodhimin e nënprodukteve bujqësore e blegtorale.
 - Pankarta, makete, udhëzues, katalogë, rregullore, standarde industriale, etj.
 - Pajisje kancelarie.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e përpunimit të produkteve bujqësore e blegtorale (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

6. Moduli “Trajtimi i kafshëve të qumështit”

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Ferma bujqësore dhe blegtorale
Niveli: II
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	TRAJTIMI I KAFSHËVE TË QUMËSHTIT	(M-14-519-10)
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi praktike për trajtimin e kafshëve në periudhën e laktacionit në fermat blegtorale.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të kualifikimit në drejtimin mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi trajton lopët në periudhën e laktacionit. <i>Përmbajtja</i> <ul style="list-style-type: none">– Përgatitja e veshjes për shërbimet në stallë.– Përzgjedhja e ambjentit për lopët e qumështit.– Sigurimi i kushteve higjienike në stallë.– Sigurimi i klimës së përshtatshme në stallë.– Përzgjedhja e veglave dhe e pajisjeve për pastrimin e trupit të lopëve.– Mbajtja e higjienës së trupit të kafshëve.– Përzgjedhja e veglave për ushqyerjen e lopëve.– Përzgjedhja e ushqimeve për lopët në laktacion.– Hartimi dhe përgatitja e racionit ushqimor.– Ndarja racionale e ushqimit për lopë.– Hedhja e ushqimit në grazhdë.– Përgatitja e lopëve për mjelje.– Mjelja e lopëve.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së ambjentit gjatë trajtimit të lopëve në laktacion. <i>Instrumentet e vlerësimit:</i> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli.– Pyetje-përgjigje me gojë. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përgatisë uniformën për kryerjen e shërbimeve në stallë.– të përzgjedhë stalla me hapësirë të mjaftueshme për qëndrimin dhe lëvizjen e lopëve.– të largojë në kohën e duhur plehun nga stalla.– të pastrojë dhe dezinfektojë vendqëndrimin e kafshës.	

- të sigurojë temperaturën dhe ajrimin normal të mjedisit në stallë.
- të kryejë pastrimin e lëkurës së trupit të kafshës sipas teknikës përkatëse.
- të përzgjedhë mjetet dhe pajisjet që përdoren për pastrimin e trupit të lopëve
- të realizojë pastrimin dhe ruajtjen e higjienës së trupit të lopëve.
- të përzgjedhë mjetet e nevojshme për ushqyerjen e lopëve.
- të përzgjedhë ushqimet për lopët në laktacion.
- të hartojë dhe përgatitë racionin ushqimor, sipas fazave të laktacionit.
- të bëjë ndarjen racionale e ushqimit për lopë.
- të hedhë me kujdes ushqimin në grazhdë.
- të përgatitë lopët për mjelje sipas kushteve higjieno-sanitare.
- të realizojë mjeljen me dorë ose në mënyrë mekanike sipas mundësive.
- të zbatojë rregullat të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së ambjentit gjatë trajtimit të lopëve në laktacion.

RM 2 Nxënësi trajton delet e dhitë gjatë periudhës së laktacionit.

Përmbajtja

- Përgatitja e uniformës së punës dhe mjeteve për shërbime në dele e dhi.
- Kujdesi për qengjat dhe kecat gjatë pirjes së kulloshtrës dhe qumështit tek nënat.
- Shkëputja e qengjave dhe kecape nga nënat.
- Kujdesi për higjienën e gjirit në dele e dhi.
- Mjelja e e deleve dhe e dhive.
- Shënimi i sasisë së qumështit të mjelë.
- Hartimi i racionit ushqimor për çdo litër qumësht në dele e dhi.
- Ushqyerja e deleve dhe e dhive në stalla.
- Përgatitja e mjedisit për kullotjen e kafshëve.
- Të ushqyerit e deleve ose dhive në kullota.
- Zbatimi i rregullave të sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve dhe trajtimit të deleve e dhive.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë uniformën dhe veglat e punës për shërbimet në dele e dhi.
- të kujdeset për qengjat dhe kecat për pirjen e kulloshtrës në sasinë dhe kohën e duhur.

- të përcaktojë periudhën e qumështit (mëmëzimit) në qengja e keca.
- të kontrollojë peshën trupore të qengjave e kecape dhe kohën e shkëputjes nga nëna.
- të përgatisë racionin ushqimor për dhentë e dhitë në laktacion sipas prodhimit të qumështit.
- të kryejë pastrimin, larjen, masazhin e gjirit në dele e dhi.
- të kryejë mjeljen në dele e dhi sipas vakteve.
- të shënojë sasinë në litër të qumështit te mjelë në dele e dhi.
- të përzgjedhë llojin e ushqimit sipas nevojës së kafshës në regjimin stallor si: hasëlle, bar i thatë, gjethe dushku, silazh, koncentrat, etj.
- të përcaktojë territorin e duhur për kullotjen e deleve ose dhive.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve dhe trajtimit të deleve e dhive. gjatë laktacionit.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në territorin e fermës së shkollës dhe territore të tjera të përshtatshme pranë shkollës.
- Mësuesi/instruktori mund të organizojë edhe vizita në ferma blegtorale të cilat mbarështojnë lopë, dele e dhi me regjim stallor dhe kullosor dhe që janë në periudhën e laktacionit.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të punëve që kryhen për trajtimin e të kafshëve gjatë periudhës së laktacionit, në bazën prodhuese të shkollës dhe ekonomi blegtorale.
- Instruktori duhet të përdorë tekste standarde dhe manuale që kanë të bëjnë me metodat e trajtimit të kafshëve në laktacion.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune në fermën e shkollës dhe ambiente të tjera të përshtatshme për trajtimin e kafshëve në periudha të ndryshme të laktacionit, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për njohuritë e marra për trajtimin e kafshëve të qumështit.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Fermë për rritjen e kafshëve.
 - Pajisje dhe vegla pune për pastrimin e stallës dhe trupit të kafshëve.
 - Furça, sfungjerë, kashai, thika druri.
 - Peshqirë, pece, kova uji për higjienën e gjirit.
 - Aparat për mjelje mekanike.
-

-
- Bidonë apo tanke për ruajtjen e qumështit.
 - Tokë kullosore.
 - Magazinë ushqimi.
 - Depo silazhi.
 - Tabela analitike të ushqimeve.
 - Tabela për nevojat ushqimore të kafshëve.
 - Mjete të tjera vizuale.
 - Materiale studimore.
 - Video me demonstrime të ndryshme.
-

7. Moduli “Kujdesi gjatë riprodhimit të kafshëve bujqësore”

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Ferma bujqësore dhe blegtorale
Niveli: II
Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	KUJDESI GJATË RIPRODHIMIT TË KAFSHËVE BUJQËSORE	(M-14-520-10)
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për t’u kujdesur për kafshët bujqësore të fermës gjatë riprodhimit të tyre.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të kualifikimit në drejtimin mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi njihet me ndërtimin dhe funksionin e organeve të riprodhimit. Përmbajtja</p> <ul style="list-style-type: none">– Përzgjedhja e mjedisit ku do të punohet me kafshët.– Përcaktimi i pjesëve përbërëse të organeve të riprodhimit në kafshët femra dhe meshkuj.– Përcaktimi i pozicionit të organeve gjinore femërore dhe mashkullore në kafshë të ndryshme.– Përcaktimi i funksioneve të organeve të riprodhimit në kategoritë e ndryshme të kafshëve.– Kujdesi për mjedisin gjatë punës që kryhet me kafshët. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli.– Pyetje-përgjigje me gojë. <p>Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përzgjedhë mjedisin për të punuar me kafshët që do të vrotohen për pozicionet e organeve gjinore.– të përcaktojë saktë pjesët përbërëse të organeve të riprodhimit në kafshët femra dhe meshkuj.– të përcaktojë saktë pozicionin anatomik të organeve gjinore femërore dhe mashkullore të sistemit të riprodhimit.– të përcaktojë me përpikmëri funksionet e organeve femërore dhe mashkullore të riprodhimit. <p>RM 2 Nxënësi njihet me gjëndjen për çiftëzim në tufë. Përmbajtja</p> <ul style="list-style-type: none">– Zgjedhja e tufës për çiftëzimin e kafshëve.	

- Kontrolli për gjëndjen e shenjave të afshit në tufë.
- Deklarimi i frekuencës së gjëndjes së afshit, fazat, ciklet dhe kohëzgjatjen e gjëndjes së afshit.
- Kujdesi për tufën gjatë çiftëzimit.
- Përcaktimi i moshës dhe peshës kur kafsha futet në ndërzim herë të parë.
- Përzgjedhja e metodës së insiminimit natyral ose artificial.
- Përgatitja e kafshëve në fermë për insiminim (ndërzim).
- Përcaktimi i mënyrave të kontrollit gjatë çiftëzimit të kafshëve.
- Mbajtja e të dhënave dhe regjistrimi i operacioneve të punës fermën e kafshëve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë kafshët që do të çiftëzohen në tufë (lopë,dele, dosa,etj.);
- të përcaktojë saktë shenjat e gjendjes së afshit për një lloj kafshe;
- të deklarojë saktë frekuencën dhe kohëzgjatjen e gjendjes së afshit për lloje të ndryshme kafshësh;
- të kujdeset për tufën gjatë procesit të çiftëzimit;
- të përcaktojë moshën dhe peshën për kafshët që do të futen në ndërzim për herë të parë;
- të përzgjedhë metodën për insiminimin (ndërzimin) e kafshëve në tufë në dele ose lopë;
- të zbatojë saktë kriteret që nevojiten për çiftëzimin e kafshëve;
- të kontrollojë ecurinë e procesit të insiminimit dhe të mbajë shënimet përkatëse.

RM 3 Nxënësi kujdeset për tufën gjatë mbarsmërisë.

Përmbajtja

- Përzgjedhja e ambientit për trajtimin e kafshëve barse.
- Përcaktimi i kohëzgjatjes së mbarsmërisë në kategori të ndryshme kafshësh.
- Trajtimi i kafshëve në faza të ndryshme të mbarsmërisë dhe parambrojtja veterinare.
- Kryerja e lëvizjes së kafshëve barse në stalla të veçanta.
- Të ushqyerit e kafshëve në periudha të ndryshme të mbarsmërisë.
- Kontrolli i kafshëve në periudhën e fundit të mbarsmërisë.
- Mbajtja e shënimeve dhe regjistrimi i operacioneve të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit në stalla.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë ambientin për mbajtjen e kafshëve barse sipas fazave fiziologjike të mbarsmërisë.
- të përcaktojë kohëzgjatjen e mbarsmërisë në kafshët e ndryshme të tufës.
- të trajtojë kafshën barse në periudha të ndryshme, si laktacion, tharje deri në pjellje.
- të zbatojë masat veterinarë dhe higjienike në kafshët barse.
- të kryejë lëvizjen e kafshëve barse në stalla të veçanta sipas gjëndjes fiziologjike.
- të ushqejë kafshët barse në periudha të ndryshme të mbarsmërisë me racione të caktuara ushqimore.
- të kontrollojë gjëndjen e kafshëve në muajin e fundit të mbarsmërisë.
- të bëjë rregjistrimin e operacioneve të punës të kryera në stallë.
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit në stalla.

RM 4 Nxënësi kujdeset për tufën gjatë pjelljes dhe për të porsalindurit.

Përmbajtja

- Përgatitja e kompletit të veshjes së përshtatshme.
- Përdorimi i regjistrave për të parashikuar pjelljen e kafshës.
- Dallimi i shenjave të afrimit të pjelljes.
- Kontrolli i gjendjes së gjirit në kafshët barse.
- Sigurimi i mjeteve ndihmëse për pjelljen normale dhe jo norm
- Përcaktimi i peshës normale e të porsalindurit.
- Trajtimi për nënën pas pjelljes.
- Trajtimi për të porsalindurit.
- Dhënia e kulloshtres së parë të porsalindurit.
- Trajtimi i të porsalindurve në mjedise të veçanta.
- Mbajtja e të dhënave dhe regjistrimi i operacioneve të punës në fermën e kafshëve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të realizojë me korrektësi radhën e përgatitjes për punë;
- të përcaktojë nëpërmjet regjistrave datën e pjelljes së kafshës;
- të dallojë shenjat e afrimit të pjelljes;
- të kontrollojë gjendjen e gjirit në muajin e fundit të mbarsmërisë në kafshë;
- të përcaktojë saktë një lindje normale dhe jo normale;
- të përcaktojë saktë peshën e të porsalindurve;
- të trajtojë nënën pas procesit të pjelljes nga ana higjienike dhe ushqimore;
- të trajtojë të porsalindurit nga ana higjienike dhe ushqimore;
- të zbatojë masat e ndihmës dhe të kujdesit për të porsalindurin;

- të realizojë dhënien e kulloshtrës së parë, në sasinë dhe cilësi e duhur;
- të kryejë trajtimin e të porsalindurve në mjedise të veçanta si bokse, në profilaktor, në stalla etj.
- të mbajë të dhënave dhe të regjistrojë operacionet e punës në fermën e kafshëve bujqësore.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik për kujdesin e tufës gjatë pjelljes dhe për të porsalindurve.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në territorin e fermës së shkollës dhe territore të tjera të përshtatshme pranë shkollës.
- Mësuesi/instruktori mund të organizojë edhe vizita në ferma blegtorale të cilat mbarështojnë blegtorinë me regjim stallor dhe kullosor.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të metodave të riprodhimit (çiftëzimit) të kafshëve me metoda të ndryshme me kafshë të gjalla për të identifikuar gjendjen e afshit si dhe asistimi në procesin e pjelljes së kafshëve në bazën prodhuese të shkollës dhe ekonomi blegtorale.
- Instruktori duhet të përdorë tekste standarde dhe manuale që kanë të bëjnë me metodat e riprodhimit të kafshëve të fermës dhe përshtatshmëria për lloje të ndryshme kafshësh.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune në fermën e shkollës dhe ambiente të tjera të përshtatshme për trajtimin e kafshëve në periudha të ndryshme fiziologjike, me të porsalindurit, me kafshët e reja, me përzgjedhjen e ushqimeve me synimin për t'i futur për herë të parë kafshët në riprodhim në peshën dhe moshën e duhur, me higjenën e kafshëve, me procesin e pjelljes, etj., fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për njohuritë e marra për riprodhimin e kafshëve, trajtimin e kafshëve në periudhën e çiftëzimit, të kafshëve barse, të porsalindura dhe të kafshëve të reja.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Fermë për rritjen e kafshëve (me lopë, dele, derra, etj.).
 - Stacion inseminimi, rregjistër ndërzimi.
 - Materiale studimore.
 - Organe riprodhimi të marra në thertore.
 - Tabela dhe makete të organeve të riprodhimit.
 - Mjete të tjera vizuale.
 - Video me demonstrime të ndryshme.
-

X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar

1. Moduli “Sistemimi estetik i kopshteve”

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Ferma bujqësore dhe blegtorale
Niveli: II
Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	SISTEMIMI ESTETIK I KOPSHTEVE	M-14-521-10
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer sistemimin estetik të kopshteve.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësit kryejnë punime përgatitore për sistemimin estetik të kopshteve.</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">– Përcaktimi i sipërfaqes për sistemimin estetik të kopshteve.– Përzgjedhja e mjeteve dhe veglave të punës për sistemimin estetik të kopshteve.– Transporti i mjeteve dhe veglave të punës.– Interpretimi i skicës së gatshme për sistemimin estetik të kopshteve.– Skicimi me përmasat e kopshteve.– Marrja e mostrës së tokës për analizë.– Përcaktimi i drejtimeve të horizontit.– Përcaktimi i llojit të bimësisë.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit për sistemimin estetik të kopshteve. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Pyetje – përgjigje me gojë.– Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përcaktojnë sipërfaqen për sistemimin estetik të kopshteve, sipas hapësirave të tij (zbukuruese, shlodhëse si dhe pjesa ku vendosen veglat e punës).– të përzgjedhin mjetet dhe veglat e punës që nevojiten për	

-
- sistemimin estetik të kopshteve.
 - të transportojnë mjetet dhe veglat e punës sipas kërkesave teknike.
 - të interpretojnë skicën e gatshme për sistemimin estetik të kopshteve, sipas modeleve të dhëna.
 - të skicojnë kopshtin me përmasa së bashku me objektet dhe gjelbërimin ekzistues.
 - të marrin mostrën e tokës për analizë për të përcaktuar llojin e tokës.
 - të përcaktojnë drejtimet e horizontit (Veri, Lindje, Jug, Perëndim) me busull ose sipas orientimit të njohur të objektit kryesor.
 - të përcaktojnë llojin e bimësisë (bar, bimësi e ulët, shkurre dhe drurë) që do të përdoret për sistemimin estetik të kopshteve, sipas modeleve të dhëna.
 - të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë sistemimit estetik të kopshteve.

RM 2 Nxënësit strukturojnë kopshtin.

Përmbajtja:

- Përcaktimi i vendeve ku do të bëhen drenazhimi, sistemi i ujitjes, rrugicat dhe rrethimi i kopshtit.
- Përzgjedhja e veglave dhe mjeteve për kryerjen e drenazhimit, sistemit të ujitjes, rrugicave dhe rrethimin e kopshtit.
- Hapja e kanaleve drenazhuese brenda kopshtit.
- Montimi i sistemit të ujitjes brenda kopshtit.
- Ndërtimi i rrugicave brenda kopshtit.
- Ndërtimi i vendeve shlodhëse brenda kopshtit.
- Rrethimi i kopshtit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë drenazhimit, sistemit të ujitjes, ndërtimit të rrugicave dhe rrethimit të kopshtit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të përcaktojnë vendet ku do të bëhen drenazhimi, sistemi i ujitjes, rrugicat dhe rrethimi sipas teknologjisë që i përshtatet kopshtit.
- të përzgjedhin veglat dhe mjetet që nevojiten për kryerjen e drenazhimit, sistemit të ujitjes, rrugicave dhe rrethimin e kopshtit.
- të hapin kanalet drenazhuese brenda kopshtit me rënie 60-90 cm për çdo 100 m tokë horizontale.
- të montojnë sistemin e ujitjes brenda kopshtit sipas mënyrës që i përshtatet (me rubinet e tub gome, në formë shiu dhe me pika).

- të ndërtojnë rrugicat brenda kopshtit sipas skemës së dhënë duke përdorur gurë, guriçka, tulla, pllaka etj.
- të ndërtojnë vendet shlodhëse brenda kopshtit
- të rrethojnë kopshtin me mur ose gardh.
- të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë drenazhimit, sistemit të ujitjes, ndërtimit të rrugicave dhe rrethimit të kopshtit.

RM 3 Nxënësit realizojnë sistemimin estetik të kopshtit të shtrirë në gjithë livadhin.

Përmbajtja:

- Interpretimi i skicës së gatshme për sistemimin estetik të kopshtit të shtrirë në gjithë livadhin.
- Përzgjedhja e bimësisë.
- Mbjellja e barit në lëndinë.
- Mbjellja e fidanëve të bimësisë.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik gjatë sistemimit estetik të kopshtit të shtrirë në gjithë livadhin.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të interpretojnë skicën e gatshme të dhënë për sistemimin estetik të kopshtit të shtrirë në gjithë livadhin.
- të përzgjedhin bimësinë sipas skemës së dhënë.
- të mbjellin barin e fortë në lëndinë sipas skemës së dhënë.
- të mbjellin fidanet e bimësisë sipas skemës së dhënë.
- të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik gjatë sistemimit estetik të kopshtit të shtrirë në gjithë livadhin.

RM 4 Nxënësit realizojnë sistemimin estetik të kopshtit të kombinuar.

Përmbajtja:

- Interpretimi i skicave të gatshme për sistemimin estetik të kopshtit të kombinuar.
- Ndërtimi i rrugëzës.
- Ndërtimi i vendeve shlodhëse.
- Përzgjedhja e bimësisë.
- Mbjellja e barit.
- Mbjellja e fidanëve të bimësisë.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik gjatë sistemimit estetik të kopshtit të kombinuar.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të interpretojnë skicat e gatshme të dhëna për sistemimin estetik të kopshtit të kombinuar.
- të ndërtojnë rrugëzën me gurë dhe guriçka sipas skemave të dhëna.
- të ndërtojnë vendet shlodhëse brenda kopshtit të kombinuar, sipas skemave të dhëna.
- të për zgjedhin bimësinë sipas skemave të dhëna.
- të mbjellin barin sipas skemave të dhëna.
- të mbjellin fidanet e bimësisë sipas skemave të dhëna.
- të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik gjatë sistemimit estetik të kopshtit të kombinuar.

RM 5 Nxënësit kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike për sistemimin estetik të kopshtit.

Përmbajtja:

- Kostot për sistemimin estetik të kopshteve.
- Preventivi i materialeve, kostoja për materialet.
- Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.).
- Kosto të tjera (transport dhe makineri).
- Të ardhurat, fitimi, llogaritja e fitimit në sistemimin estetik të kopshtit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të njehsojnë kostot për sistemimin estetik të kopshtit.
- të njehsojnë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë kostot e tjera (transport dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogaritin të ardhurat dhe fitimin në sistemimin estetik të kopshtit.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në një mjedis të përshtatshëm në shkollë ose pranë saj.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur skica të gatshme të sistemimit estetik të kopshteve, si dhe demonstrime konkrete të proceseve për sistemimin estetik të tij.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve për sistemimin estetik të kopshtit fillimisht në mbikëqyrje dhe pastaj në mënyrë të pavarur.
- Nxënësit duhet të përfshihen në kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike të proceseve të punës për sistemimin estetik të kopshtit.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë edhe përdorimin e

mirëmbajtjen e veglave dhe mjeteve që përdoren për sistemimin estetik të kopshtit.

- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së veglave e mjeteve të punës.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për sistemimin e sistemimin estetik të kopshtit si dhe për llogaritje të thjeshta ekonomike.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohet mjedisi për krijimin e kopshtit, veglat, pajisjet, dhe baza materiale e mëposhtme:

- Mjedisi për kopshtin.
 - Vegla dhe pajisje pune për sistemimin estetik të kopshtit.
 - Pankarta, skica të gatshme, udhëzues, katalogë etj.
 - Farë bari ose tapet bari
 - Bimësi e ulët (lule të ndryshme) sipas skemave
 - Bimë shkurrore sipas skemave
 - Pajisje për ujitje, kangjella për gardh, tulla, gurë, guriçka etj.
 - Mjete për ndërtim bankash shlodhëse etj
 - Pajisje kancelarie.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e sistemimit sistemimin estetik të kopshtit (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

2. Moduli “Shtimi dhe shërbimet te hardhia”

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Ferma bujqësore dhe blegtorale
Niveli: II
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	SHTIMI DHE SHËRBIMET TE HARDHIA	M-14-522-10
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që zhvillon tek nxënësi aftësi dhe shkathtësi për të mbjellë, prodhuar e nxjerrë në treg kultivarë rrushi cilësor, si dhe të llogarisë shpenzimet për to.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të kualifikimit në drejtimin mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi shton hardhinë në mënyra të ndryshme.</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">– Përgatitja e mjeteve dhe materialeve për shtimin e hardhisë.– Sigurimi i farave dhe i copave për shtimin e hardhisë.– Teknika e shtimit me farë i hardhisë.– Teknika e shtimit me copa të hardhisë.– Teknika e shtimit me përpaja e hardhisë.– Teknika e shartimit në vend të hardhisë.– Teknika e shartimit në tavolinë e hardhisë.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zbatimit të teknika të ndryshme të shtimit të hardhisë. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përgatitë mjetet dhe materialet e nevojshme për shtimin e hardhisë.– të sigurojë farat, copat dhe përpajnat për shtimin e hardhisë.– të realizojë shtimin me farë i hardhisë, sipas procedurës teknike.– të realizojë shtimit me copa të hardhisë, sipas procedurës teknike.– të realizojë shtimin me përpaja të hardhisë, sipas procedurës teknike.– të realizojë shartimin në vend të hardhisë, sipas	

-
- procedurës teknike.
 - të realizojë shartimin në tavolinë të hardhisë, sipas procedurës teknike.
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zbatimit të teknikave të ndryshme të shtimit të hardhisë.

RM 2 Nxënësi mbjell fidanët e hardhisë.

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e mjeteve e materialeve për përgatitjen, sistemimin dhe piketimin e tokës.
- Përgatitja e tokës për mbjelljen e fidanëve të hardhisë.
- Përcaktimi i numrit të bimëve.
- Përcaktimi i distancave të mbjelljes.
- Piketimi i sipërfaqës së tokës për mbjelljen e fidanëve të hardhisë.
- Mbjellja e fidanëve të hardhisë
- Kryerja e shërbimeve pas mbjelljes së fidanëve të hardhisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë mjetet e materialet e nevojshme për përgatitjen, sistemimin dhe piketimin e tokës, për mbjelljen e fidanëve të hardhisë.
- të përgatitë tokën për mbjelljen e fidanëve të hardhisë, sipas procedurës së punës.
- të përcaktojë numrin e bimëve për sipërfaqen e caktuar për mbjellje.
- të përcaktojë distancat midis rreshtave dhe të bimëve në rresht.
- të piketojë sipërfaqen e tokës për mbjelljen e fidanëve të hardhisë, sipas distancave të përcaktuara.
- të mbjellë fidanët e hardhisë, sipas kushteve teknike.
- të kryejë shërbimet pas mbjelljes së fidanëve të hardhisë në momentin e duhur.

RM 3 Nxënësi krasit hardhinë në sisteme e forma të ndryshme.

Përmbajtja:

- Vendosja e shtyllave dhe e telave.
- Teknika e krasitjes formuese.
- Teknika e krasitjes së shkurtër.
- Teknika e krasitjes së gjatë.
- Teknika e sistemit të krasitjes së përzier.
- Kryerja e lidhjeve të thata e të gjelbra.
- Kryerja e operacioneve të gjelbra.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së krasitjes në sisteme e forma

të ndryshme të hardhisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të vendosë me kujdes sipas distancës, shtyllat dhe telat.
- të kryejë krasitjen formuese, sipas procedurës teknike.
- të kryejë krasitjen e shkurtër, sipas procedurës teknike.
- të kryejë krasitje të gjatë sipas procedurës teknike.
- të realizojë sistemin e krasitjes së përzier duke formuar hallkën ose hallkat e prodhimit, sipas procedurës teknike.
- të kryejë lidhjet e thata e të gjelbra, në momentin e duhur.
- të kryejë operacionet e gjelbra në kohën e duhur.
- të zbatojë rregullat esigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së krasitjes në sisteme e forma të ndryshme të hardhisë

RM 4 Nxënësi vjel dhe ambalazhon prodhimin e hardhisë.

Përmbajtja:

- Sigurimi dhe përzgjedhja e mjeteve dhe e materialeve për vjeljen dhe ambalazhimin e prodhimit të hardhisë.
- Përcaktimi i kohës së vjeljes së prodhimit të hardhisë.
- Teknika e vjeljes së prodhimit të hardhisë.
- Vendosja e prodhimit në arka.
- Seleksionimi i prodhimit.
- Ambalazhimi dhe etiketimi i prodhimit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë vjeljes dhe ambalazhimit të prodhimit të hardhisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të sigurojë dhe përzgjedhë mjetet dhe materialet për vjelje.
- të përcaktojë kohën e vjeljes së prodhimit sipas destinacionit të prodhimit.
- të vjelë në kohën e duhur prodhimin e hardhisë, sipas destinacionit.
- të vjelë me dorë me shumë kujdes, prodhimin e hardhisë
- të vendosë bistakët e rrushit nëpër arka me shumë kujdes pa e dëmtuar atë.
- të seleksionojë prodhimin e hardhisë sipas standardit të kërkuar.
- të ambalazhojë dhe etiketojë prodhimin, sipas standardit dhe kërkesës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë vjeljes dhe ambalazhimit të prodhimit të

hardhisë.

RM 4 Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta ekonomike të shtimit të hardhisë dhe përkujdesjeve për të.

Përmbajtja:

- Kostot e shtimit të hardhisë dhe të përkujdesjeve, si dhe përbërësit e kostove.
- Preventivi i materialeve, kostoja për materialet.
- Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.).
- Kosto të tjera (transport dhe makineri).
- Të ardhurat, fitimi, llogaritja e fitimit në një biznes të vogël për shtimin dhe përkujdesjet e hardhisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të njehsojnë kostot e shtimit dhe të shërbimeve të hardhia, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë kostot e tjera (transport dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogaritin të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për shtimin dhe shërbimet të hardhia.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në bazën prodhuese të shkollës ose në vreshta afër saj.
- Gjatë trajtimit të modulit mësuesi i praktikës ose vreshtari duhet të përdorë sa më shumë demonstrime konkrete të proceseve të punës për shtimin dhe shërbimet që kryhen të hardhia.
- Nxënësit duhet të praktikohen sa më shumë të jetë mundur për kryerjen e proceseve të punës të shtimit të hardhisë dhe të shërbimeve që kryhen në vreshtari.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për kryerjen e llogaritjeve të thjeshta për shtimin dhe shërbimet të hardhia.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve dhe materialeve për shtimin dhe shërbimet të hardhia.
- Mësuesi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së proceseve të punës për shtimin dhe shërbimet të hardhia.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të

shtimit dhe shërbimeve të hardhia, si dhe llogaritjeve të thjeshta ekonomike në lidhje me to.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Ferma e shkollës
- Vresht
- Mjete pune për shtimin dhe shërbimet të hardhia.
- Pankarta, makete, udhëzues, kataloge, rregullore, standarde në lidhje me shtimin dhe shërbimet të hardhia etj.
- Pajisje kancelarie.
- Makina llogaritëse dore.
- Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
- Përmbledhje e legjislacionit në fushën e shtimit të kultura bujqësore që lidhet me shtimin dhe shërbimet të hardhia (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
- Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.

3. Moduli: “Përgatitja me krah e barit të thatë”

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Ferma bujqësore dhe blegtorale
Niveli: II
Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PËRGATITJA ME KRAHË E BARIT TË THATË	(M-19-240-09)
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit për të kryer procese pune të përgatitjes me krahë të barit të thatë si ushqim për blegtorinë.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimorë	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të kualifikimit në drejtimin mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi pret/korr me krah, bar të njomë dhe jonxhë. Përmbajtja <ul style="list-style-type: none">– Përgatitja e kompletit të veshjes së përshtatshme.– Përgatitja e veglave për prerjen e barit dhe të jonxhës.– Përcaktimi i fushë/zonës ku do të kryhet prerja/korrja.– Transportimi i veglave në vendin e përcaktuar.– Pastrimi i fushës nga objekte të forta apo mbeturina të tjera.– Largimi i mbeturinave.– Përcaktimi i kohës së ndërhyrjes për prerje.– Kryerja e prerjes së barit të njomë dhe jonxhës.– Zbatimi i rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë transportit të veglave dhe prerjes së barit të njomë dhe jonxhës. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit: <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përgatitë siç duhet kompletin e veshjes së përshtatshme për prerjen/korrjen e barit të njomë/jonxhës.– të përgatitë siç duhet veglat për prerjen e barit dhe të jonxhës: drapër, kosë e të tjera materiale ndihmëse.– të përcaktojë fushën/zonën ku do të kryhet prerja/korrja, sipas kriterëve të duhura.– të përcaktojë saktë kohën e korrjes së jonxhës për bar të thatë – para lulëzimit.– të transportojë me shumë kujdes veglat në vendin e përcaktuar.– të bëjë me shumë kujdes pastrimin e fushës nga objekte të	

-
- forta apo mbeturina të tjera.
 - të largojë me kujdes mbeturinat nga fusha e caktuar për korrje.
 - të kryejë prerjen e barit të njomë dhe të jonxhës me drapër ose me kosë.
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë transportit të veglave dhe prerjes së barit të njomë dhe jonxhës.

RM 2 Nxënësi kryen operacione pune për tharjen e barit dhe jonxhës.

Përmbajtja

- Shpërndarja e barit dhe e jonxhës së korrur.
- Kthimi i barit dhe i jonxhës.
- Mbledhja e barit dhe e jonxhës në grumbuj.
- Rishpërndarja e barit dhe e jonxhës së grumbulluar.
- Rikthimi i barit dhe i jonxhës.
- Kontrolli organoleptik i vazhdueshëm i cilësisë së barit dhe jonxhës gjatë tharjes.
- Ngarkimi përfundimtar i barit të thatë për transport.
- Zbatimi i rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së operacioneve të punës për tharjen e barit dhe të jonxhës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të shpërndajë siç duhet barin dhe jonxhën e korrur duke përdorur vegla krahu si cfurk etj.
- të kthejë sipas rregullit barin dhe jonxhën.
- Të mbledhë barin dhe jonxhën në grumbuj sipas rregullit dhe në kohën e duhur.
- të rishpërndajë barin dhe jonxhën sipas rregullit dhe në kohën e duhur.
- të rikthejë barin dhe jonxhën për tharje sipas rregullit.
- të kryejë vazhdimisht kontrollin organoleptik të cilësisë së barit dhe jonxhës gjatë tharjes.
- të ngarkojë me shumë kujdes barin e thatë në mjetet e transportit.
- të zbatojë siç duhet rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së operacioneve të punës për tharjen e barit dhe të jonxhës.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në bazën prodhuese të shkollës ose në parcela të mbjella me pranë shkollës.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për prerjen/korrjen dhe tharjen e barit të njomë dhe jonxhës.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për

prerjen/korrjen dhe tharjen e barit të njomë dhe jonxhës, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.

- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me operacionet e punës që kryhen për tharjen
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e tharjes së barit dhe të jonxhës.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen fermë bujqësorë, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Sipërfaqe e mbjellë me jonxhë.
 - Kosë, drapër.
 - Komplet i veshjes.
 - Manuale ose katalogje për operacionet e punës për tharjen e barit.
 - Pamje filmike të proceseve të punës gjatë korrjes, kthimit, grumbullimit, si dhe të transportit të barit të thatë dhe të jonxhës.
-

4. Moduli “Ujitja bimëve të arave e perimeve”

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Ferma bujqësore dhe blegtorale
Niveli: II
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	UJITJA BIMËVE TË ARAVE E PERIMEVE	M-14-523-10
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për kryerjen e ujitjes sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje, me shihedhje dhe me pika, si dhe për llogaritjet e thjeshta ekonomike lidhur me kryerjen e ujitjeve të ndryshme në bimët e arave e perimeve në fermë.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të kualifikimit në drejtimin mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësit kryejnë punime përgatitore për ujitjen me mënyra të ndryshme.</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">– Përzgjedhja e veglave e pajisjeve për kryerjen e ujitjeve.– Përcaktimi i tokës së mbjellë për ujitje.– Transportimi i veglave dhe i pajisjeve të nevojshme.– Interpretimi dhe skicimi i skemave të ujitjes së tokës.– Përcaktimi i mënyrës së ujitjes.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve përgatitore për ujitjen me mënyra të ndryshme. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përzgjedhin veglat, pajisjet për kryerjen e ujitjeve sipas kulturës dhe mënyrës së ujitjes.– të përcaktojnë tokën e mbjellë për ujitje sipas kulturave.– të transportojnë veglat dhe pajisjet në vendin e caktuar.– të interpretojnë dhe skicojnë sipas skicave të gatshme skema për ujitjen e tokës.– të përcaktojnë mënyrën e duhur të ujitjes sipas llojit të kulturës dhe tipit të tokës bujqësore.– të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve përgatitore për ujitjen me mënyra të ndryshme.	

RM 2 Nxënësit kryejnë ujitje sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje.

Përmbajtja:

- Përcaktimi i kulturës për ujitjen sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje.
- Përcaktimi i gjerësisë dhe i largësisë së brazdave.
- Hapja e brazdave.
- Lëshimi i ujit në brazdë.
- Përcaktimi i kohës së qëndrimit të ujit në brazdë.
- Ndjekja e lëvizjes së ujit në brazdë.
- Kryerja e ujitjes sipërfaqësore me rrëshqitje.
- Kontrolli i cilësisë së ujitjes sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje.
- Pastrimi dhe ruajtja e veglave dhe pajisjeve të ujitjes sipërfaqësore me brazda dhe rrëshqitje.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së ujitjes sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të përcaktojnë kulturën që i përshtatet ujitjes sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje.
- të përcaktojnë gjerësinë dhe largësinë e brazdave sipas llojit të tokës.
- të hapin brazdat duke zbatuar parametrat teknikë sipas përbërjes mekanike, pjerrësisë së tokës etj.
- të lëshojnë ujin në brazdë me një rrymë fillestare të caktuar për të mbërritur sa më shpejt në fund të saj.
- të përcaktojnë kohën e qëndrimit të ujit në brazdë sipas përbërjes grimcametrike të tokës.
- të ndjekin lëvizjen e ujit në brazdë sipas drejtimit të mbjelljes së bimëve.
- të kryejnë ujitjen sipërfaqësore me rrëshqitje sipas pjerrësisë së tokës.
- të kontrollojnë cilësinë e ujitjes sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje për plotësimin e kërkesave teknike.
- të pastrojnë dhe ruajnë veglat dhe pajisjet për ujitjen sipërfaqësore me brazda dhe rrëshqitje.
- të zbatojnë rregullave e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së ujitjes sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje.

RM3 Nxënësit kryejnë ujitjen me shihedhje.

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e kulturës.
- Kontrolli i impiantit shihedhës.

- Montimi i impiantit ujitës.
- Lëshimi i ujit.
- Kontrolli i vazhdueshëm gjatë kryerjes së ujitjes.
- Çmontimi i impiantit ujitës.
- Pastrimi dhe ruajtja e impiantit ujitës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së ujitjes me shihedhje.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli i punës së bërë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të përzgjedhin kulturën që i përshtatet ujitjes me shihedhje.
- të kontrollojnë impiantin shihedhës për funksionim të rregullt të tij.
- të montojnë impiantin ujitës sipas kërkesave teknike.
- të lëshojnë ujin në mënyrë të njëtrajtshme për mbulimin e të gjithë sipërfaqes.
- të kontrollojnë në mënyrë të vazhdueshme kryerjen e ujitjes për evitimin e rrjedhjeve nga tubacionet.
- të çmontojnë impiantin ujitës sipas kërkesave teknike.
- të pastrojnë dhe mirëmbajnë impiantin ujitës sipas kërkesave teknike.
- të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së ujitjes me shihedhje.

RM 4 Nxënësit kryejnë ujitjen me pika.

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e kulturës.
- Përzgjedhja e tubave, pikatoreve dhe transportimi i tyre.
- Montimi i pikatoreve në tubacione.
- Përcaktimi i normës së ujitjes.
- Lëshimi i ujit.
- Kontrolli i vazhdueshëm i ujitjes me pika.
- Çmontimi i pikatoreve.
- Pastrimi dhe ruajtja e pikatoreve.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së ujitjes me pika.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli i punës së bërë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të përzgjedhin kulturën që i përshtatet ujitjes me pika.

- të përzgjedhin pikatoret e duhura në varësi të kulturës dhe t'i transportojnë ato.
- të montojnë pikatoret në tubacione sipas kushteve teknike.
- të përcaktojnë normën e ujitjes sipas formulës së dhënë.
- të lëshojnë ujin në mënyrë të njëtrajtshme për mbulimin e të gjithë sipërfaqes.
- të kontrollojnë në mënyrë të vazhdueshme ujitjen me pika për evitimin e rrjedhjeve nga tubacionet.
- të çmontojnë tubat e çmontueshëm dhe pikatoret sipas kushteve teknike.
- të pastrojnë dhe mirëmbajnë pikatoret sipas kërkesave teknike.
- të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë ujitjes me pika.

RM 5 Nxënësit kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike për ujitjen me mënyra të ndryshme të bimëve të arave dhe perimeve.

Përmbajtja:

- Kostot e kryerjes së ujitjes sipërfaqësore me brazda, me shihedhje dhe me pika, si dhe përbërësit e kostove.
- Krahasimi i kostos së mënyrave të ndryshme të ujitjes.
- Preventivi i materialeve, kostoja për materialet.
- Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.).
- Kosto të tjera (transport dhe makineri).
- Të ardhurat, fitimi, llogaritja e fitimit në një biznes të vogël për kryerjen e ujitjes sipërfaqësore me brazda, me shihedhje dhe me pika.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të njehsojnë kostot e kryerjes së ujitjes sipërfaqësore me brazda, me shihedhje dhe me pika, sipas manualit përkatës.
- të krahasojë kostot e mënyrave të ndryshme të ujitjes
- të njehsojnë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë kostot e tjera (transport dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogaritin të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël gjatë kryerjes së ujitjes sipërfaqësore me brazda, me shihedhje dhe me pika.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në terren.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të proceseve të ujitjes sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje, me shihedhje dhe me pika.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve për ujitjen sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje, me shihedhje dhe me pika.
- Nxënësit duhet të përfshihen në veprimtari konkrete për kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike për ujitjen sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje, me shihedhje dhe me pika.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve dhe impjanteve për ujitjen sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje, me shihedhje dhe me pika.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së veglave, pajisjeve dhe impjanteve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për ujitjen sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje, me shihedhje dhe me pika si dhe për llogaritje të thjeshta ekonomike.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen terreni, veglat dhe pajisjet e punës të mëposhtme:
- Skica të gatshme me skema për rrjetin e ujitjes sipërfaqësore me brazda, me shihedhje dhe me pika.
 - Impiant për ujitjen me shihedhje dhe me pika, tubacione, etj.
 - Pajisje kancelarie.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manualet e preventivimit dhe për zberthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e hapjes së kanaleve ujitëse (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-